

Infrakos

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr.No.Br. 2/21
Dt. 13.03.2024
Fushë Kosovë - Fushe Kosova - Kosovo Polje

# RAPORTI VJETOR

# 2023

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr.No.Br. 2/19
01 13.03.2024
Fushe Kosove - Fushe Kosova - Kosovo Polje

**NDËRMARRJA PUBLIKE**

**- INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - INFRAKOS SH.A -**

13/03/2024

Mbështetur në Ligjin e Ndërmarrjeve Publike Nr. 03 / L-087, Neni 31, Paragrafi 31.3 si dhe në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, pika 28, paragrafi 28.6 dhe 28.7 Bordi i Drejtorëve i Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës „Infrakos" SH.A, në mbledhjen e mbajtur me datën 13.03.2024 mori këtë:

## VENDIM

**I. Aprovohet Raporti Vjetor për vitin 2023 i Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës „Infrakos" SH.A.**

**II. Sekretari i Korporatës i Ndërmarrjes Publike „Infrakos" SH.A, obligohet që ta procedoi Raportin Vjetor për vitin 2023 te NJPMNP - ME.**

**III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.**

**Edona Nahi**
**Kryesuese e BoD**

**z. Naser Krasniqi**
**Kryeshef Ekzekutiv**

**Vendimi i dërgohet:**

- Aksionarit – NJPMNP - ME
- Kryeshefit Ekzekutiv
- Sekretarit të Kompanisë

# Përmbajtja

1 Fjala hyrëse për aksionarin ... 6
1.1 Mesazhi i kryesuesit të bordit të drejtorëve ... 7
1.2 Aktivitetet dhe përformanca e ndërmarrjes ... 11
1.3 Kreditë ... 14
1.4 Të dhënat për Drejtorët jo ekzekutiv ... 14
1.5 Takimet e Bordit ... 14
1.6 Komitetet e Bordit ... 15
1.7 Komitetet e bordit ... 16
1.8 Informacione tjera ... 16
1.9 E ardhmja ... 17
2 Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv të INFRAKOS-it ... 18
3 Ngjarjet kryesore të vitit ... 19
3.1 Ngjarjet kryesore të vitit ... 19
3.2 Arritjet kryesore gjatë vitit 2023 ... 20
3.3 Çështjet kyçe të trajtuara gjatë vitit 2023 ... 22
4 Përformanca operative e INFRAKOS-it ... 24
4.1 Departamenti i Infrastrukturës ... 24
4.1.1 Sektori i komunikacionit ... 24
4.1.2 Numri i trenave ... 24
4.1.3 Shërbimi i qasjes në binarë ... 25
4.1.4 Terminali i mallrave ... 26
4.1.5 Aksidentet hekurudhore ... 27
4.2 Sektori për Mirëmbajtjen e Linjave Hekurudhore (MLH) ... 28
4.2.1 Mirëmbajtja dhe kontrollimi i ndërrueseve ... 28
4.2.2 Rregullimi i ndërrueseve sipas kahes dhe niveletës ... 29
4.2.3 Ndërrimi i traversave të vjetruara në ndërruese dhe linjë të hapur ... 29
4.2.4 Ndërrimi i shinave me kokë të konsumuar nëpër kthesa ... 30
4.2.5 Pastrimi dhe rregullimi i zonave të vendkalimeve në nivel ... 31
4.2.6 Rrënimi i vendkalimeve ilegale ... 31
4.2.7 Mirëmbajtja, pastrimi dhe rregullimi i kanaleve ujë përcjellëse dhe lëshesave ... 32
4.2.8 Pastrimi i profilit të lirë ... 32
4.2.9 Tharja e barojave ... 32
4.2.10 Kontrollimet e hekurudhës dhe objekteve përcjellëse ... 33
4.2.11 Mirëmbajtja e binarëve Industrial ... 33
4.2.12 Lyerja dhe përpunimi i bulonave ... 33

4.2.13 Planifikimi i koltrinës - ballastit ........................................................33
4.2.14 Pastrimi i gurëve nga tereni me pjerrësi të mëdha dhe prerjet e terenit 34
4.2.15 Pastrimi i akullit dhe bores nëpër ndërruese, vendkalime dhe tunele 34
4.2.16 Vëzhgimi i rregullt binarit dhe gjatë kohës me temperatura të larta ..34
4.3 Sektori i Veprimtarisë Elektroteknike ........................................................35
4.4 Sektori për Planifikim, Zhvillim, Standardizim dhe Siguri ............................37
4.5 Departamenti i Administratës........................................................................39
4.6 Sektori i resurseve njerëzore ........................................................................39
4.6.1 Përmbushja e objektivave nga plani i biznesit për vitin 2023 ..............40
4.6.2 Shërbimi i Shkrimores dhe arkivit.......................................................40
4.6.3 Shërbimi i logjistikës............................................................................41
4.6.4 Shërbimi i mirëmbajtjes së objekteve ..................................................41
4.7 Sektori për pronë dhe standarde ..................................................................42
4.8 Sektori i patundshmërisë ..............................................................................42
4.9 Zyra Ligjore ...................................................................................................44
4.9.1 Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it për vitin vijues .........................46
4.9.2 Përfundimet/sugjerimet dhe rekomandimet..........................................46
4.10 Sektori për marrëdhënie me publikun & marketing, shkollim & mbrojtje dhe siguri në punë...................................................................................................47
4.10.1 VIZITAT DHE AKTIVITETET KRONOLOGJIKE GJATË VITIT 2023 .49
4.10.2 VIZITAT E RADHËS NË PRILL, MAJ DHE QERSHOR TË VITIT 2023 50
4.10.3 INAUGURIMI I TUNELEVE 6 DHE 7 ...................................................52
4.10.4 Infrakos në aksionet humanitare ..........................................................53
4.11 SHËRBIMI PËR SHKOLLIM, SIGURI DHE MBROJTJE NË PUNË .........53
4.11.1 Shkollimi i Rregullt për stafin Ekzekutiv të Infrakos-it.........................54
**4.11.2** Trajnimet për e Stafit të Kompanisë Infrakos Sh.a ............................54
4.11.3 Organizimi dhe mbikëqyrja e kontrollimeve të rregullta mjekësore të punëtorëve.........................................................................................................54
4.11.4 Mbrojtja e shëndetit, ambientit dhe siguria në punë ...........................55
4.11.5 Mbikëqyrja dhe inspektimi...................................................................55
4.11.6 Mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore .......................................55
4.12 Kontrollori i brendshëm..................................................................................56
4.12.1 FUSHA E KONTROLLIT TË BRENDSHEM DHE PLANI I VEPRIMIT...........................................................................................................56
4.12.2 Inspektimet e personelit.......................................................................56
4.12.3 Gjendja e Objekteve ............................................................................57

4.12.4 Gjendja e Infrastrukturës ........ 58
4.12.5 Linja hekurudhore Mitrovicë – Fushë Kosovë – Hani i Elezit ........ 58
4.12.6 Vend Kalimet hekurudhore: ........ 59
4.12.7 Parashenjat shenjëdhënësit dhe shenjave treguese ........ 59
5 Pasqyrate performancës financiare ........ 61
5.1 Përformanca financiare e INFRAKOS-it ........ 61
5.1.1 Të hyrat e planifikuara dhe ato të realizuara ........ 62
5.2 Shpenzimet e INFRAKOS-it ........ 64
5.3 Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve ........ 64
6 Progresi sipas planit të biznesit ........ 65
6.1 Pasqyrat e progresit në zbatimin e planit të biznesit ........ 65
6.2 Progresi i objektivave kryesore strategjike ........ 65
6.3 Ndryshimet gjatë aktiviteteve ........ 69
7 Shpenzimet kapitale dhe projektet ........ 69
7.1 Shpenzimet kapitale dhe projektet ........ 69
7.1.1 Projektet kapitale nga Buxheti i Kosovës ........ 69
7.1.2 Furnizimet dhe shërbimet nga buxheti i INFRAKOS-it ........ 70
8 Perspektiva për vitin e ardhshëm ........ 70
8.1 Perspektiva për vitin 2022 ........ 70
8.2 Objektivat kryesore sipas Planit të Biznesit për vitin 2024 ........ 71
8.3 Ndryshimet nga plani i biznesit i vitit paraprak ........ 72
9 Rreziqet e së ardhmes ........ 73
9.1 Rreziqet për të ardhmen ........ 73
9.2 Rreziqet kryesore në dy vitet e ardhshme ........ 73
9.3 Komentimi i rreziqeve ........ 74
9.4 Si të veprohet ........ 75

## *Tabelat*

Tabela 1. Trenat e trenave të udhetarëve ........ 24
Tabela 2. Tabela e trenave të Mallrave ........ 25
Tabela 3. Të hyrat nga qasja në binar e operatorit Trainkos ........ 26
Tabela 4. Të hyrat nga qasja në binar e operatorit Railtrans ........ 26
Tabela 5. Te hyrat nga terminali i mallrave ........ 26
Tabela 6. Aksidentet hekurudhore ........ 27
Tabela 7. Shpenzimet e sherbimit të logjistikes ........ 41
Tabela 8. Kontratat dhe aneks kontratat nga sektori i prones ........ 43
Tabela Tabela 9. Lendet ne procedurë gjyqësore ........ 45
Tabela 10. Paraqitja totale te te gjitha te hyrave dhe shpenzimeve. **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 2. Tabela 11. Paraqitja e te gjitha te hyrave dhe shpenzimeve reale......**Error! Bookmark not defined.**
Tabela 12. Numri i projekteve të realizuara ............................................................70

# 1 Fjala hyrëse për aksionarin

## 1.1 Mesazhi i kryesuesit të bordit të drejtorëve



***Znj. Edona Nahi***

***Kryesuese e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës Sh.A - INFRAKOS***

Të nderuar,

Në vitin 2023 ndërmarrja shënoi disa përmirësime në realizimin e objektivave të afarizmit të ndërmarrjes, prej të cilave vlen të theksohet ngritja e lehtë e të hyrave, zvogëlimi i shpenzimeve si dhe zvogëlimi i borxheve të akumuluara nga vitet paraprake. Megjithatë ndërmarrja ende është larg realizimit të kënaqshëm të objektivave afarist për shkak të rënies së transportit nga operatorët e transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS, nga të cilët INFRAKOS-i i krijon të hyrat kryesore në emër të shfrytëzimit të traseve hekurudhore.

Ky vit shënon fillimin e krijimit të një stabiliteti të shumëpritur financiar për ndërmarrjen INFRAKOS, pasi që në dhjetor të vitit 2023 u nënshkrua marrëveshja pesë vjeçare financiare ndërmjet Qeverisë dhe ndërmarrjes INFRAKOS, marrëveshje kjo e paraparë me Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063. Nënshkrimi i kontratës financiare pesëvjeçare është paraparë me Direktivat e Bashkësisë Evropiane, dhe është obligim i kërkuar nga Observatori i Transportit për Evropën Jug Lindore (SEETO) dhe Traktati për Themelimin e Komunitetit të Transportit për Vendet e Ballkanit Perëndimor, nënshkrues i të cilit dokument është edhe Kosova. Praktika e nënshkrimit të kontratave të tilla ka vite të tëra që zbatohet në BE, ndërsa vitet e fundit edhe në vendet e rajonit.

Përkundër të arriturave të lartcekura, ndërmarrja INFRAKOS-i ka një rrugë të gjatë për të bërë deri tek

modernizimi i plotë infrastrukturës hekurudhore dhe përmirësimi i dukshëm i performancës afariste për të arritur një stad zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm. Pra, ndërmarrja po vazhdon të adresoj të gjeturat nga raporti i auditorit për vitin 2022 dhe rastet janë adresuar ne organet kompetente, po ashtu bazuar ne instruksionet e dhëna nga Bordi dhe implementimin e tyre nga menaxhmenti, INFRAKOS-i edhe këtë vit po auditohet nga ZKA dhe pritjet janë që raporti i ZKA-së për vitin 2023 të jetë më i mirë.

Gjatë vitit 2023, ka pasur përparim edhe në zbatimin e projekteve madhore për rehabilitimin dhe modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore, projekt ky i financuar nga huat e BERZH-it, BEI-së dhe grantet e BE-së. Si rezultat i përpjekjeve të menaxhmentit të ndërmarrjes dhe Njësisë për Implementimin e Projekteve (NJIP), me 4 nëntor 2023, është bërë rihapja e linjës hekurudhore Hani i Elezit – Fushë Kosovë. Ri-hapja e linjës është bërë me riparimin e dy tuneleve (tuneleve 6 dhe 7) të cilët kanë qenë të shembur që nga shtatori i vitit 2022, duke bllokuar qarkullimin e trenave në linjën Hani i Elezit – Fushë Kosovë për më shumë se 1 vit dhe duke i shkaktuar ndërmarrjes humbje të konsiderueshme.

Prioritet tjetër ka qenë vendosja e stabilitetit në menaxhimin e ndërmarrjes me qëllim të zvogëlimit të dëmeve dhe përmirësimit të afarizmin të ndërmarrjes. Për të stabilizuar ndërmarrjen, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar proceset e rekrutimin për tri pozitat e larta zyrtare, atë të Kryeshefit Ekzekutiv (KE), dhe Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF), dhe Auditorit të Brendshëm. Vlen të ceket që procesi i rekrutimit për KE ka qenë i monitoruar nga përfaqësuesit e Projektit Britanik për Rekrutim në Pozita të Larta. Për më tepër, dhe me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, INFRAKOS ka lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Konsorciumin e Organizatave të Shoqërisë Civile të përbërë nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), të cilat janë duke monitoruar proceset e brendshme të qeverisjes korporative, duke përfshirë rekrutimin dhe prokurimin.

Bordi i Drejtorëve ka pasur angazhime të vazhdueshme në mbikëqyrjen e zbatimit të detyrave të përcaktuara me Planin e Veprimit të kompanisë dhe realizimin e politikave të përcaktuara me Planin e Biznesit për vitin 2023, qoftë sa i përket zbatimit të akteve ligjore dhe rregulloreve përkatëse, qoftë sa i përket mirëmbajtjes së infrastrukturës, rregullimit të komunikacionit hekurudhor, menaxhimit të pronës dhe ofrimit të shërbimeve tjera përkatëse, apo qoftë edhe në monitorimin e zbatimit të projekteve zhvillimore të kompanisë.

Në fund, dua të theksoj se hekurudhat luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe janë një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës ekonomike të vendit, duke ndihmuar në lëvizjen e mallrave dhe njerëzve në mënyrë efikase, krijimin e vendeve të punës dhe lidhjen e komuniteteve, andaj investimi në

hekurudhë është një hap kritik në përmirësimin e konkurrencës ekonomike të vendit tonë në nivel rajonal dhe ndërkombëtarFjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv



***Z. Naser KRASNIQI***

***Kryeshef Ekzekutiv në NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. - INFRAKOS***

Të nderuar/a zonja dhe zotërinj,

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS SH.A, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për hekurudha bënë menaxhimin e traseve hekurudhore me vizion të qartë që të ofroj shërbimet cilësore të infrastrukturës hekurudhore për të gjithë operatoret e transportit hekurudhor. INFRAKOS vazhdon të punoj që të kemi një rrjet hekurudhor konkurrues me rajonin, të siguroj qëndrueshmëri financiare me synimin final që të përmbush nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë se Kosovës.

INFRAKOS vazhdon të operoj me një rrjet hekurudhor në të cilin nuk ka pasur investime adekuate për vite të tëra në rrjetin hekurudhor, gjendja e rrjetit të INFRAKOS-it është në rehabilitim e sipër dhe për këtë kërkohen investime të mëdha në përmirësimin dhe funksionalizimin e plotë të këtij rrjeti. Për këtë arsye, të mbështetur nga Qeveria e Kosovës, Grantet e BE-së, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe Banka Evropiane e Investimeve, ne kemi filluar me zbatimin e projekteve zhvillimore të infrastrukturës.

Në këtë kontekst, këto vite një fokusim të jashtëzakonshëm e kemi në implementimin e projekteve zhvillimore me të cilat do bëhet modernizimi i linjës se 10-të hekurudhore si dhe angazhimi në projekte tjera për linja të reja dhe për t’i ri-aftësuar dhe modernizuar linjat ekzistuese si dhe duke ofruar projekte edhe për linja të reja hekurudhore Gjatë vitit 2023 vazhduam projektin për rehabilitimin e përgjithshëm të fazës së parë të linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit), po ashtu është vazhduar puna në rehabilitimin e fazës se dytë (Fushë Kosovë - Mitrovicë) dhe jemi

në hartimin e Projektit për rehabilitimin e përgjithshëm të fazës së tretë (Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë). Këto projekte tregojnë përkushtimin tonë maksimal për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës hekurudhore për të përmbushur kriteret e ndërveprimit (interoperabilitetit ) të kërkuara nga direktivat e BE-së. Si dhe në vitet në vijim në planin afat mesëm do të fokusohemi në rehabilitimin e linjtëve Fushë Kosovë-Pejë, Klinë – Prizren, Prishtinë - Aeroport dhe Prishtinë - Merdare, po ashtu linja e re Ferizajt – Gjilan - Presheve. Po ashtu fokus të veçantë do të jetë edhe linja e re Durrës – porti i thatë Prishtinë.

Gjatë vitit 2023 sfidë kryesore ka qenë gjendja e vështirë financiare që e përcjellë këtë kompani qe disa vite, mirëpo ne kemi arritur se bashku me aksionarin qe ta tejkalojmë edhe këtë sfidë me nënshkrimin e marrëveshjes 5 vjeçare financiare e cila ka ndodhë për herë të parë qe nga themelimi i Infrakos-it për çka jemi falënderues ndaj aksionarit për besueshmërinë e menaxhimit në këtë aset shtetëror. Ne shpresojmë qe me një koordinim shumëdimensional i të gjithë akterëve të përfshirë në sektorin hekurudhor në vend është i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit hekurudhor.

Ne besojmë fuqishëm që planet tona të realizohen në tërësi, sepse kjo do të mundësonte zhvillimin e rrjetit hekurudhor, shërbime cilësore dhe një sektor hekurudhor të qëndrueshëm brenda kornizave të një realiteti ekzistues. Rrjeti hekurudhor ekziston për të ofruar vlerë të shtuar për taksapaguesit dhe konsumatorët. Kjo kërkon identifikimin e saktë të mundësive financiare të kompanisë dhe investimeve afatgjata në infrastrukturën hekurudhore dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve për të cilat zotohemi që do të punojmë fuqishëm.

Krejtësisht në fund, vlerësoj se hekurudha paraqet një segment të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, ruajtjen e ambientit dhe shërbimeve adekuate për konsumatorët e transportit hekurudhor, andaj investimi në hekurudhë nënkupton një zhvillim të qëndrueshëm me ndikim pozitiv ekonomik, ambiental dhe social në vend dhe me gjerë.

## 1.2 Aktivitetet dhe përformanca e ndërmarrjes

Bordi i Drejtorëve, menaxhmenti dhe të gjithë punonjësit e INFRAKOS kanë qenë të përkushtuar për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në Planin e Biznesit dhe Planin e Veprimit gjatë gjithë vitit 2023.

Ky vit është karakterizuar me vazhdimin e pandërprerë e misionit tonë, që nga mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore deri tek organizimi i trafikut hekurudhor si dhe janë kryer detyrat të ndryshme administrative, si raportimi, bashkëpunimi, komunikimi etj.

Gjatë vitit të kaluar kemi vazhduar përpjekjet tona drejt rehabilitimit dhe modernizimit të përgjithshëm të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit - Kufiri me Maqedoninë e Veriut). Faza e dytë ka vazhduar me projektin e rehabilitimit të hekurudhës Fushë-Kosovë – Mitrovicë dhe është e rëndësishme të theksohet se ky projekt është duke u financuar nga BERZH, EIB dhe burime të tjera financimi, ndërsa të gjitha projektet e tjera të përmendura këtu financohen nga grantet e BE-së. Kjo është një arritje e rëndësishme për INFRAKOS-in dhe një dëshmi e përkushtimit tonë të palëkundur në realizimin e projekteve zhvillimore.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të raporteve, informacioneve dhe dokumenteve të tjera të ofruara nga menaxhmenti, si dhe mbikëqyrjes së rregullt të punës së realizuar në kompani, Bordi i Drejtorëve të INFRAKOS-it ka ardhur në përfundimin se përformanca e kompanisë për vitin 2023 ishte e jashtëzakonshme në historinë e Infrakos-it, pavarësisht sfidave të shumta me të cilat u përballën stafi i NP-së Infrakos. Përkushtimi i të gjithë punonjësve të INFRAKOS-it u përqendrua në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe të shkëlqyer, transparencë të plotë dhe efikasitet të madh për të gjithë përdoruesit e shërbimeve tona. Vlen të theksohet se Infrakos qe nga ndarja në vitin 2011 për herë të parë në vitin 2023 ka performuar me rezultat operativ pozitiv neto edhe përkundër obligimeve nga vitet e kaluara performanca ka qenë e shkëlqyer.

Vlen të përmendet po ashtu qe gjatë vitit 2023 janë zvogëluar dukshëm obligimet publike të viteve të kaluara duke mos krijuar obligime të




rej




*Figura 1. Skema e rezultatit operativ*

Megjithatë, viti 2023 për Infrakos-in ka qenë në vështirësi financiare të cilat vështirësi janë akumuluar gjatë viteve të fundit për shkak të uljes së transportit të mallrave dhe ndërprerjes së qarkullimit të trenave të mallrave dhe pasagjerëve (për çka janë përgjegjës TRAINKOS si operatori publik i transportit hekurudhor dhe RAILTRANS, si operator privat).

Një ndër aktivitetet me të rëndësishme gjatë vitit 2023 ka qenë hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes financiare 5 vjeçare ndërmjet Infrakos-it dhe Qeverisë se Republikës se Kosovës. Ne kemi qenë konsistent në kërkesat tona ligjore dhe falë mbështetjes dhe përkrahjes se vazhdueshme të Ministrisë se Ekonomisë dhe Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kjo marrëveshje është nënshkruar.

Kjo marrëveshje parasheh zotimin e Qeverisë së Republikës se Kosovës në investimin në infrastrukturën hekurudhore të Kosovës, rritjen e sigurisë se shërbimit të transportit hekurudhor, avancimin dhe modernizimin, sigurimin e stabilitetit financiar të ndërmarrjes dhe ruajtjen e kontinuitetit të kuadrove profesionale.





Aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të INFRAKOS-it gjatë tërë vitit 2023 kanë qenë shumë të mëdha dhe të orientuara në drejtim të funksionimit me efikasitet me të lartë të kompanisë, por edhe për zhvillimet në të ardhmen. Analizat e mirëfillta dhe marrja e masave adekuate konform situatave aktuale në të cilën gjendej kompania ka ndikuar që mos të bllokohet funksionimi normal i kësaj kompanie. Bordi i Drejtorëve gjithnjë ka marrë vendimet e nevojshme ashtu që të zbatohen politikat e përcaktuara paraprakisht me planin e biznesit drejt realizimit të detyrave dhe projekteve zhvillimore ashtu që kompania të ketë një përformancë pozitive.

Një punë e palodhshme është bërë edhe në vazhdimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet INFRAKOS-it dhe institucioneve të ndryshme vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Bordi gjithnjë e ka përkrahur dhe inkurajuar menaxhmentin që të zhvillojnë raporte të mira me të gjitha institucionet në interes të zhvillimit të rrjetit hekurudhor dhe kompanisë në tërësi.

Një ndër vizitat me të rëndësishme për vitin 2023 ishte ajo e Kroacisë e cila u realizua në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellët e cila fillimisht kishte edhe karakter njohës rreth funksionimit të sistemit hekurudhor të Kroacisë si njëra ndër shtetet me të zhvilluara në rajon sa i përket rrjetit dhe sistemit hekurudhor.



Përvoja dhe funksionimi i hekurudhave të Kroacisë ishte një model i mirë i qeverisjes se korporatës se hekurudhave të cilët treguan gatishmëri të një bashkëpunimi të ndërsjellët.

Pra ekipet profesionale të kësaj fushe organizuan një takim të përmasave në interes të kërkesave tona.



Gjatë vitit 2023 në veçanti është bërë përmbushja e obligimeve ligjore të cilat i ka Bordi ndaj aksionarit. Të gjitha kërkesat e aksionarit janë marrë me prioritet të lartë dhe me kohë është dhënë informacioni i kërkuar në secilën prej tyre. Këtu bëjnë pjesë edhe raportimet e rregullta, vlerësimet e përformancës, testimi i kënaqshmërisë së klientëve dhe dokumentet tjera të cilat bordi në mënyrë të rregullt i ka dërguar tek aksionari.

## 1.3 Kreditë

Në vitin 2023 ka vazhduar realizimi i projektit të Linjës së 10 Hekurudhore i cili siç dihet financohet nga BERZH-i dhe BEI-ja përmes kredive të kontraktuara në fund të vitit 2015 dhe grantet e BE-së. Projekti i rehabilitimit gjeneral të linjës së 10 hekurudhore është i parapare dhe do të realizohet në tri faza:

- Faza 1: Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë;
- Faza 2; Fushë Kosovë – Mitrovicë; dhe
- Faza 3: Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë

Është me rëndësi të ceket se kreditë e marra nga BERZH-i dhe BEI-ja janë kredi të kthimit afatgjatë (për të cilat garantues është Qeveria e Republikës së Kosovës), ndërsa kamata kthyese është tepër e vogël. Vlen të ceket se gjysma e vlerës së investimeve për këtë projekt madhor jepet në formë të granteve nga fondet e BE-së përmes mekanizmit të WBIF-it.

## 1.4 Të dhënat për Drejtorët jo ekzekutiv

Pas dorëheqjes të z. Dukagjin Kastrati nga pozita e kryesit të Bordit të Drejtoreve, me datën 14.09.2022 me vendim Nr. 19/96 të Qeverisë së Republikës së Kosovës kryesuese e Bordit emërohet Edona Nahi. Përbërja e Bordit të përkohshëm është në përbërje si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Znj. Edona Nahi | Kryesuese e BpD |
| 2 | Znj. Besarta Zuka | Anëtare e BpD |
| 3 | Z. Shpend Gjugja | Anëtar i BpD |
| 4 | Z. Genc Hundozi | Anëtar i BpD |

Bordi i përkohshëm i Drejtoreve ka pasur mandat deri me datën 13.02.2023, ndërsa me datë 22.03.2023 me Nr. 07/136 Qeveria e Republikës së Kosovës emëron Bordin e Drejtorëve në NP ,,INFRAKOS" SH.A në përbërje si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Znj. Edona Nahi | Kryesuese e BoD |
| 2 | z. Genc Hundozi | Anëtar i BoD |
| 3 | Znj. Besarta Zuka | Anëtare e BoD |
| 4 | Z. Fitim Raci | Anëtar i BoD |

## 1.5 Takimet e Bordit

Bordet e Drejtorëve të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS SH.A gjatë vitit 2023 kanë mbajtur takimet e rregullta në mënyrë që të përcjellin punën e kompanisë dhe të marrin vendimet e nevojshme

për përformancën e saj. Gjatë vitit 2023 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime në të cilat janë trajtuar të gjitha çështjet relevante të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe funksionimin normal të kompanisë.

Në të gjitha takimet e mbajtura gjatë vitit 2023, Bordet e Drejtorëve kanë analizuar me kujdes të madh raportet e menaxhmentit dhe në veçanti gjendjen e sigurisë dhe atë financiare dhe gjithnjë kanë marrë vendimet e duhura në mënyrë që INFRAKOS-i të operojë pa problem. S'do mend se sfida kryesore ka qenë gjendja e vështirë financiare në të cilën ka qenë kompania e për të cilën Bordet në bashkëpunim me menaxhmentin kanë pasur angazhime të përhershme se si të dilet

nga kjo situatë e pa lakmueshme. Kuptohet se përballë kësaj gjendjeje janë marrë edhe vendimet adekuate për tejkalimin e saj, por njëkohësisht janë bërë edhe kërkesat drejt institucioneve qeveritare për mbështetjen e kompanisë me subvencionin meritor. Bordet në mënyrë permanente kanë bërë analizat e gjendjes së infrastrukturës hekurudhore me theks të veçantë në aspektin e sigurisë, duke sugjeruar dhe duke kërkuar angazhime maksimale për mirëmbajtje të rregullt dhe intervenime të nevojshme për ngritjen e sigurisë të kësaj infrastrukture.

Në takimet e bordeve janë analizuar, diskutuar dhe miratuar të gjitha dokumentet strategjike të kompanisë, përfshirë këtu: planet e biznesit, raportet kuartale, gjashtëmujore dhe vjetore, raportet e kënaqshmërisë së klientëve, pasqyrat financiare, raportet e auditimit, e shumë e shumë çështje tjera në interes të kompanisë.

## 1.6 Komitetet e Bordit

Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, statutit të kompanisë dhe rregulloreve tjera përkatëse, gjatë vitit 2023 INFRAKOS-i ka pasur të themeluar nga Ministria e Ekonomisë vetëm Komisionin e Auditimit i cili Komision ka pasur mandat deri me datën 28.02.2023. Përbërja e këtij komiteti ka qenë si në tabelën vijuese: Ministria e Ekonomisë me datën 28.03.2023 me nr. Pr. 1072 ka emëruar Komisionin e Auditimit në këtë përbërje:

| *Nr.* | *Emri i anëtarëve* | *Pozita* |
|---|---|---|
| *1* | *Shpend Gjugja* | *Kryesues* |
| *2* | *Besarta Zuka* | *Anëtare* |
| *3* | *Genc Hundozi* | *Anëtar* |

| *Nr.* | *Emri i anëtarëve* | *Pozita* |
|---|---|---|
| *1* | *Genc Hundozi* | *Kryesues* |
| *2* | *Besarta Zuka* | *Anëtare* |
| *3* | *Fitim Raci* | *Anëtar* |

## 1.7 Komitetet e bordit

Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, statutit të kompanisë dhe rregulloreve tjera përkatëse, gjatë vitit 2023 INFRAKOS-i ka pasur të themeluar vetëm Komitetin e Auditimit.

Vlen të përmendet këtu edhe angazhimi maksimal i të gjithë anëtarëve të Komiteteve të Auditimit të cilët kanë punuar shumë në drejtim të mbarëvajtjes së punëve të kompanisë.

Gjatë vitit 2023 Komiteti i Auditimit ka mbajtur takime në të cilat janë trajtuar të gjitha çështjet nën kompetencën e këtij komiteti.

Një ndër aktivitetet me të rëndësishme gjatë vitit 2023 ky komitet i ka marrë të gjitha veprimet ligjore rreth rekrutimit të Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm gjë qe është bërë përzgjedhja e ZAB-it nëpërmjet konkursit të jashtëm.

## 1.8 Informacione tjera

Viti 2023 ka qenë një vit i vështirë, por edhe një vit në të cilin janë bërë punë të shumta si në aspektin e mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore si po ashtu edhe në vazhdimin e realizimit të projektit të modernizimit të infrastrukturës hekurudhore.

Gjatë vitit 2023, Bordi i Drejtorëve i INFRAKOS-it ka pasur angazhime të përhershme në ruajtjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, ashtu që të kemi një nivel të lartë të sigurisë, duke ofruar shërbimet e kërkuara nga shfrytëzuesit e kësaj infrastrukture. Ne me kënaqësinë më të madhe mund të konstatojmë se gjatë tërë vitit 2023 nuk kemi pasur asnjë aksident hekurudhor për fajin e INFRAKOS-it. Kjo për ne është sukses i lartë qe do të thotë se ka pasur përkushtim të madh.

Një punë tejet e rëndësishme është bërë edhe në menaxhimin e pronës hekurudhore nga e cila kemi të hyrat e dyta më të rëndësishme të kompanisë. Bordi i Drejtorëve ka diskutuar rregullisht çështjen e pronës duke kërkuar nga menaxhmenti angazhimin maksimal dhe duke e përkrahur atë në të gjithë hapat e ndërmarrë për ruajtjen e pronës dhe eliminimin e dëmtimeve të infrastrukturës hekurudhore.

Bordet e Drejtorëve gjatë tërë kohës kanë bërë mbështetjen e menaxhmentit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, duke analizuar dhe marrë vendim meritor për secilën kërkesë të drejtuar në emër të Bordit të Drejtorëve. Qëndrimi i jonë tejet korrekt dhe zbatimi me përkushtim i legjislacionit në fuqi, e sidomos zbatimi i statutit të kompanisë, ka ndikuar që gjatë tërë vitit të mos kemi as më të voglin problem, andaj kjo ka rezultuar me një përformancë të kënaqshme, si dhe kemi rikthyer një

besim të plotë nga aksionari me realizimin e marrëveshjes financiare 5 vjeçare e cila është bërë e mundur nga Qeveria e Republikës se Kosovës.

Angazhimet e vazhdueshme të bordeve kanë qenë edhe si motiv për stafin menaxhues të kompanisë për realizimin e detyrave të përcaktuara me planin e biznesit.

## 1.9 E ardhmja

Për fat të mirë në vitin 2023 kemi arritur dy marrëveshje të subvencionimit dhe NP Infrakos është në rrugë të mbarë drejt rimëkëmbjes fal menaxhimit efektiv si në aspektin afarist dhe financiar.

Ndikim të madh do të kenë edhe zhvillimet të cilat pritet të ndodhin në vitin 2023, e sidomos vazhdimi i rehabilitimit gjeneral të segmentit të parë po ashtu edhe vazhdimi i punimeve në rehabilitimin e segmentit të dytë të Linjës së 10 Hekurudhore, me ç'rast do të vërehet një ndryshim i madh dhe një lëvizje pozitive e cila do të ketë ndikim edhe tek qytetarët e Kosovës, por edhe tek institucionet e vendit për përkrahjen meritore të hekurudhës.

Ne jemi të vetëdijshëm se investimi në sektorin hekurudhor kërkon mjete të mëdha dhe se kthimi i këtyre investimeve është i ngadaltë. Por në të njëjtën kohë ne e dimë se një shtet i cili nuk e ka të zhvilluar sektorin hekurudhor, nuk ka bazën themelore të zhvillimit ekonomik. Për këtë arsye ne kemi punuar pa ndarë qe ta realizojmë marrëveshjen financiare pesëvjeçare në mbështetje të INFRAKOS-it e cila tashmë është bërë realitet.

Përveç angazhimeve në rehabilitimin dhe modernizimin e linjave kryesore hekurudhore, ne do të punojmë jashtëzakonisht shumë edhe në mirëmbajtjen e linjave ekzistuese në funksion të plotë ashtu që të mos cenohet asnjëherë siguria e qarkullimit të trenave.

Ne jemi të bindur se pa një rrjet hekurudhor modern i cili i plotëson kërkesat e interoperabilitetit nuk do të ketë integrim në rrjetin e hekurudhave rajonale dhe aq më pak në Rrjetin e Integruar të Hekurudhave të BE-së. Prandaj, fillimi i modernizimit dhe më pastaj vazhdimi i modernizimit të tërë Rrjetit Hekurudhor të Kosovës, është kusht i domosdoshëm që ne të jemi pjesë e rrjetit të Integruar të BE-së. Ne jemi të përgatitur që në çdo kohë dhe në çdo moment të ofrojmë siguri të lartë dhe t'i plotësojmë të gjitha kërkesat e operatorëve hekurudhor të transportit, në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese. INFRAKOS-i është i gatshëm dhe e mirëpret hapjen e tregut hekurudhor për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor, sepse vetëm me një hapje të tregut të transportit dhe konkurrencë të mirëfilltë mund të ecet përpara.

Përfundimisht, viti 2023 ka qenë viti i sfidave dhe nismave të mëdha, ndërsa viti 2024 do të jetë viti i zhvillimeve të mëdha në infrastrukturën hekurudhore, kështu që

me bindje të thellë mund të konstatojmë se INFRAKOS-in po e pret një e ardhme më e mirë e cila e ardhme është e lidhur edhe me të ardhmen më të mirë të vendit. Mirëpo që vizioni ynë të realizohet me sukses, ne presim përkrahjen e vazhdueshme nga Qeveria e Republikës se Kosovës respektivisht ministritë e linjave.

# 2 Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv të INFRAKOS-it

Raporti vjetor për vitin 2023 është bazuar në kornizën e Udhëzuesit të Ministrisë së Ekonomisë mbi përpilimin e raporteve vjetore. Ne kemi tentuar që në mënyrë të detajuar të përshkruajmë gjendjen e kompanisë duke iu përmbajtur pikave të udhëzuesit si në vijim:

Duke iu përmbajtur udhëzuesit në fjalë në vazhdim të këtij raporti janë trajtuar në kapituj të veçantë të gjitha pikat e lartshënuara. Është tentuar që ky raport të jetë sa më i shkurtër, konciz dhe i njëjti lexuesit t'i ofrojë të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që të krijohet një opinion i drejtë mbi ecurinë e INFRAKOS-it në vitin 2023.

Janë paraqitur ngjarjet kryesore të cilat kanë ndodhur në kompani gjatë vitit 2023 dhe të cilat janë me interes për aksionarin dhe publikun. Është tentuar që të jepet një informatë e plotë për ngjarjet kryesore të cilat kanë ndodhur në vitin 2023, duke i analizuar ato me të rëndësishme. Sidoqoftë, përshkrimi i ngjarjeve kryesore të vitit paraqet edhe mënyrën dhe rrugën të cilën INFRAKOS-i e ka zgjedhur për realizimin e objektivave të përcaktuara me planin e biznesit për vitin 2023.

Në kapitullin mbi performancën operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës janë përshkruar të arriturat e secilit departament të kompanisë duke i paraqitur edhe rezultatet apo dështimet eventuale, gjithnjë duke i krahasuar ato me planet e veprimit të bazuara në Planin e Biznesit për vitin 2023. Rëndësi më e madhe i është kushtuar departamenteve ekzekutive të cilat kanë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe eksploatimin e infrastrukturës hekurudhore, por nuk janë lënë fare anash as departamentet tjera mbështetëse.

Në kapitullin mbi pasqyrat e performancës financiare dhe rezultatet, janë prezantuar të hyrat dhe shpenzimet e realizuara të kompanisë, duke i krahasuar ato me Planin e Biznesit për vitin 2023 dhe vitin paraprak 2022. Në këtë kapitull janë prezantuar në mënyrë të detajuar të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e kompanisë duke bërë sqarimet e duhura për secilin zë buxhetor.

Në kapitullin mbi progresin me planin e biznesit janë prezantuar të arriturat, respektivisht realizimi i detyrave sipas Planit të Biznesit për vitin 2023. Marrë

parasysh se INFRAKOS-i ka pasur një plan të mirë dhe gjithëpërfshirës të biznesit, atëherë në këtë kapitull është bërë krahasimi ndërmjet objektivave të parapara dhe realizimi i këtyre objektivave.

Në kapitullin mbi shpenzimet kapitale dhe projektet është bërë pasqyrimi detaj i projekteve kapitale të financuara nga buxheti i shtetit dhe projekteve (furnizimeve) tjera të realizuara nga buxheti i kompanisë.

Në kapitullin mbi perspektiven për vitin e ardhshëm është bërë paraqitja e ideve, objektivave dhe planeve vepruese, apo më mirë të themi vizionit për vitin vijues, duke përshkruar se cilat janë mundësitë, por po ashtu edhe cilat janë sfidat të cilat e presin INFRAKOS-in gjatë vitit 2024.

Në kapitullin mbi rreziqet e së ardhmes është prezantuar SWOT analiza e kompanisë, duke i analizuar përparësitë, mangësitë, mundësitë dhe rreziqet të cilat mund ta përcjellin INFRAKOS-in edhe gjatë vitit 2024. Në këtë kapitull është bërë përshkrimi i SWOT analizës duke qartësuar se cilat mund të jenë rreziqet të cilat e presin INFRAKOS-in në të ardhmen, cilat janë mundësitë, mangësitë dhe cila është fuqia e kësaj kompanie.

# 3 Ngjarjet kryesore të vitit

## 3.1 Ngjarjet kryesore të vitit

Viti 2022 dhe viti 2023 do të mbahet gjatë në mend për luftën në Ukrainë, luftë kjo e cila ndryshoj çmimet e tregut dhe shkaktoi një inflacion në tërë Globin tokësor, në Kosovë por edhe në INFRAKOS. Ndikimi negativ i kësaj lufte është shumë i qartë edhe në biznesin e INFRAKOS-it dhe përkundër gjendjes së vështirë financiare të trashëguar nga vitet paraprake kjo gjendje gjatë vitit 2023 u përkeqësua edhe më shumë.



Përkundër kësaj gjatë vitit 2023 ka pasur zhvillime të mëdha për Sistemin Hekurudhor të Kosovës, respektivisht për Menaxherin e Infrastrukturës – INFRAKOS. Arritjet tona përkundër mangësive të caktuara kanë qenë mbresëlënëse, andaj për hir të informimit të drejtë, në vijim janë paraqitur ngjarjet më të rëndësishme të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2023.

- **Investimet në modernizim** - Viti 2023 ishte viti i cili karakterizohet me vazhdimin e investimeve të shumëpritura në modernizimin e infrastrukturës hekurudhore. Gjatë këtij viti ka vazhduar të bëhet rehabilitimi i fazës së parë (Fushë Kosovë – Hani i Elezit) i linjës së 10 hekurudhore.

Kontrata e fazës së parë është paraparë që të përfundon më 30.12.2022, mirëpo pas shumë

negociatave duke vlerësuar riskun e ndërprerjes së kontratës dhe mundësinë e ballafaqimit në gjykata ndërkombëtare, me datën 12.07.2023 kemi arritur nënshkrimin e Adendumit Nr.4 i cili zgjat kontratën në mes të Infrakos dhe punë kryesit për përfundimin e tërësishëm të punimeve në linjën e 10 hekurudhore faza e parë (Hani i Elezit – Fushë-Kosovë) deri më 30.09.2024.

Gjatë vitit 2023 po ashtu kanë vazhduar punimet në fazën e dytë të linjës 10-të hekurudhore (Fushë-Kosovë – Mitrovicë). Data e fillimit të punimeve për fazën e dytë është 10.10.2022 ndërsa data e përfundimit 08.01.2024, mirëpo edhe me marrëveshjen Nr. 2 të datës 08.01.2024, vazhdojnë punimet deri me 08.02.2024.

- **Realizimi i detyrave** – Një punë tejet e madhe gjatë vitit 2023 është bërë edhe në realizimin e detyrave të përcaktuara paraprakisht sipas planit të veprimit të kompanisë. INFRAKOS gjatë pjesës së dytë të vitit ka punuar shumë në ndryshimin e qasjes të secilit ndaj detyrave të punës duke ngritur shumë lartë përgjegjësinë për realizimin e detyrave dhe në veçanti duke e ngritur në një nivel shumë të lartë transparencën për secilin veprim. Kjo është bërë edhe përmes rishkrimit të disa rregulloreve tepër të rëndësishme për funksionimin e kompanisë.

## 3.2 Arritjet kryesore gjatë vitit 2023

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. – INFRAKOS, në vitin 2023 ka pasur arritje historike qe nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani të reja, duke i përmbushur obligimet ligjore në realizimin e marrëveshjes financiare 5 vjeçare, duke e zbatuar me përkushtim planin e biznesit për vitin 2023, respektivisht planin e veprimit sipas këtij plani të biznesit. Sfidat kanë qenë të mëdha, mirëpo falë angazhimeve tona të përhershme është arritur që të kemi një sukses të mirë gjatë realizimit të detyrave tona.

INFRAKOS-i ka pasur shumë arritje në vitin 2023 por ne këtu do të përmendim disa prej tyre të cilat ne i konsiderojmë si më të rëndësishmet:

- Arritja dhe realizimi i marrëveshjes financiare 5 vjeçare
- Vazhdimi i realizimit të projektit të rehabilitimit të linjës së 10 hekurudhore;
- Ruajtja dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë për të gjitha linjat hekurudhore të cilat për momentin janë në operim;
- Rregullimi i sektorit të patundshmërisë;
- Zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Ri sistematizimi i vendeve të punës

**Vazhdimi i rehabilitimit të linjës së 10 hekurudhore** – Njëra ndër arritjet kryesore gjatë vitit 2023

ndërlidhet me vazhdimin e punëve në projektin e rehabilitimit dhe modernizimit të Linjës së 10 hekurudhore. Ne presim që përkundër vonesave dhe problemeve gjatë implementimit në renovimin e tuneleve dhe urave ky projekt të përfundohet me sukses në vitin vijues.

**Ruajtja dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë** – Njëra ndër arritjet kryesore gjatë vitit 2023 ndërlidhet me mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore në nivelin e kërkuar përkatësisht linjës Prishtinë – Pejë, ashtu që komunikacioni hekurudhor i udhëtarëve dhe ai i mallrave të zhvillohet në sigurinë më të lartë të mundshme. Falë angazhimeve maksimale të departamenteve të mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, veprimtarisë elektroteknike dhe atij të komunikacionit, kemi arritur që gjatë vitit 2023 të mos kemi asnjë aksident të komunikacionit hekurudhor i cili ka ndodhur për shkak të infrastrukturës. Kjo ishte një sfidë tejet e madhe të cilën INFRAKOS-i e ka tejkaluar me shumë sukses.

**Rregullimi i sektorit të patundshmërisë** – Duke ditur se njëra ndër të hyrat më të rëndësishme të INFRAKOS-it krijohet nga patundshmëria, gjatë vitit 2023 kemi ndërmarrë një aktivitet tjetër shumë të madh për rregullimin e procedurave në sektorin e patundshmërisë, kujdesin më të madh për pronën e sidomos angazhimin për mbledhjen e borxheve të mbetura. Që kjo të arrihet INFRAKOS-i ka hartuar dhe miratuar një rregullore mbi pronën e cila është shumë e avancuar dhe mundëson një transparencë maksimale në sektorin e pronës duke përshkruar në detaje të gjitha procedurat e dhënies me qira të pronës së INFRAKOS-it.

**Përtëritja e stafit dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore** – Duke marrë parasysh nevojën e domosdoshme për trajnim dhe edukim të stafit ekzistues (sidomos në sektorët ekzekutiv), INFRAKOS-i gjatë tërë vitit është marrë në mënyrë të rregullt me trajnimin e stafit ekzistues për nevojat e kompanisë. Politikat tona kanë qenë dhe mbesin të tilla që të bëhet edhe ngritja e kapaciteteve njerëzore, prandaj për këtë shkak të gjendjes së vështirë financiare nuk kemi qenë në gjendje që të dërgojmë kuadrot tona për trajnime jashtë vendit, por kjo është bërë brenda kompanisë.

**Bashkëpunimi me institucionet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare** – Njëra ndër të arriturat shumë të rëndësishme është edhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet e ndryshme. Ne gjatë vitit 2023 kemi zhvilluar një bashkëpunim shumë të madh me të gjitha komunat ku graviton hekurudha në drejtim të ruajtjes së sistemit hekurudhor, si dhe kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyer edhe me institucionet tjera vendore.

Ndërsa sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar vlen të përmendet se ne kemi punuar në vazhdimësi me të gjithë akterët ndërkombëtarë të interesuar për zhvillimin e sektorit hekurudhor, duke filluar nga takimet me institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH, BEI, etj.), e deri tek institucionet vendim marrëse siç janë: Komuniteti Evropian

Hekurudhor (CER), Komisioni Evropian (EC), Sekretariatin mbi themelimin e komunitetit të Transportit për Ballkanin Perëndimor (TCS), e kështu me radhë. Një punë e rëndësishme do të bëhet në vitin pasues ku Hekurudhat e Kosovës do të bëjnë aplikime zyrtare për anëtarësim në institucione të rëndësishëm hekurudhore, qofshin ato evropiani apo të karakterit ndërkombëtarë.

Vlen të theksohet se kemi pasur takime edhe me përfaqësuesit e hekurudhave Kroate në mënyrë qe të njoftohemi lidhur me modalitetet e ristrukturimit dhe funksionimit të hekurudhave, pasi qe është menduar se në rajon do të kemi mundësinë të jemi model i një qeverisje të NP-së të këtij sistemi.

Pretendimet tona kanë qenë dhe mbeten që ne duhet të punojmë shumë në sferën e bashkëpunimit me të gjitha institucionet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të sektorit hekurudhor, sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'i qojmë gjërat përpara, gjithnjë në drejtim dhe interes të zhvillimit të sektorit hekurudhor i cili sektor ka rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

## 3.3 Çështjet kyçe të trajtuara gjatë vitit 2023

Dinamika e punëve për të cilat është përgjegjës INFRAKOS-i e kapë një fushë të madhe dhe ndërlidhet me veprimtari të ndryshme. Analizat tona të shpeshta dhe të rregullta nuk kanë lejuar që të bëhen gabime eventuale të cilat do të kishin një kosto të pa paraparë. Trajtimi i të gjitha çështjeve të cilat ndërlidhen me funksionimin normal të INFRAKOS-it është bërë me kujdesin më të madh. Ka shumë çështje të cilat në mënyrë permanente i kemi trajtuar gjatë tërë vitit, por ne do t'i përmendim disa prej tyre:

- Zbatimi i detyrave ditore dhe planeve të veprimit;
- Gjendja financiare e kompanisë;
- Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit 2024;
- Hartimi i marrëveshjes financiare Qeveri – INFRAKOS; dhe
- Hartimi i Planit të Biznesit për vitin 2024

**Zbatimi i detyrave ditore dhe planeve të veprimit** – Zbatimi i detyrave ditore dhe planeve të veprimit është tema e cila gjatë vitit 2023 është trajtuar më së shumti. Përcjellja e secilit sektor dhe departament është bërë përmes raporteve të veçanta, raporteve mujore, kuartaleve duke diskutuar dhe trajtuar çështjet më të ndjeshme, problemet dhe sfidat që i ka pasur ekzekutivi. Në kuadër të kësaj aty ku ka qenë e mundur është vepruar menjëherë duke evituar mangësitë eventuale në përmirësimin e veprimeve jo adekuate.

Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, shpeshherë kemi ardhur në një situatë që të mos kemi mundësi të realizojmë blerjen e pjesëve rezervë dhe atyre të domosdoshme për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore. Mirëpo, falë angazhimeve tona dhe mirëkuptimit nga ana e ekzekutivit,

është arritur që të përfundojmë me sukses evitimin e secilës pengesë në procesin e punës.

**Gjendja financiare e kompanisë –** Një punë e madhe është bërë edhe në trajtimin e pasqyrave financiare ashtu që kompania të mund të jetë likuide dhe të funksionoj pa problem. Në bazë të gjendjes financiare janë marrë vendime strategjike rreth veprimeve të caktuara.

**Hartimi i Ekspozeu i Rrjetit 2023 –** Një çështje kyçe e cila ndërlidhet me funksionimin normal të kompanisë dhe ndërlidhet me krijimin e të hyrave kryesore është Ekspozeu i Rrjetit. Ky dokument i rëndësisë se veçantë do të mbetët strategjik në të ardhmen atëherë kur linjat do të funksionojnë normal pas rehabilitimit të arteries kryesore të linjës se 10-të hekurudhore.

**Hartimi dhe realizimi i Marrëveshjes Financiare Qeveri - INFRAKOS –** Ndër çështjet të cilat janë trajtuar në mënyrë permanente gjatë vitit 2023 e cila edhe është realizuar ka qenë nënshkrimi i marrëveshjes financiare pesëvjeçare ndërmjet qeverisë dhe INFRAKOS-it. Kjo marrëveshje është e paraparë me Ligjin mbi Hekurudhat Nr. 04 / L – 63 dhe përcakton financimin e kompanisë në kohëzgjatje pesëvjeçare, duke përfshirë këtu subvencionimin dhe financimin e projekteve kapitale të INFRAKOS-it.

Për fat të mirë pas përkushtimit të madh nga ana e Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit kjo marrëveshje është nënshkruar ndërmjet dy palëve dhe për këtë ne e falënderojmë aksionarin për kujdesin e veçantë dhe mbështetjen e vazhdueshme për Infrakos-in.

**Hartimi i planit të biznesit për vitin 2024 –** Si zakonisht edhe gjatë vitit 2023 INFRAKOS-i e ka trajtuar me kujdes hartimin e planit të biznesit për vitin 2024 i cili është një plan real dhe gjithëpërfshirës. Vlen të përmendet se ky plan i biznesit është hartuar në pajtim me kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, respektivisht bazuar në rekomandimet e NJPMNP-së ashtu që të prezantohen objektivat njëvjeçare të kompanisë.

Si përfundim mund të themi se angazhimet tona në vitin 2023 kanë qenë të mëdha, çështjet e trajtuara kanë qenë të shumëllojshme dhe të fushave të ndryshme gjithnjë në interes të zhvillimit të kompanisë. Aty ku puna dhe zhvillimi është varur nga ne, angazhimi i jonë nuk ka munguar asnjëherë dhe zbatimi i detyrave ka qenë në nivelin e duhur. Ne shpresojmë dhe besojmë se viti 2024 do të jetë vit i kthimit kah hekurudhat dhe zhvillimet e këtij sektori jetik për zhvillimin ekonomik të vendit.

# 4 Përformanca operative e INFRAKOS-it

## 4.1 Departamenti i Infrastrukturës

### 4.1.1 Sektori i komunikacionit

Gjatë muajve (janar – mars) 2023 vazhdimisht është marrë me ofrimin e shërbimeve për nevoja të operatorëve të transportit hekurudhor (TRAINKOS – it dhe RAILTRANS-it), veçanërisht me përcjelljen dhe rregullimin e lëvizjes së sigurt të trenave, qoftë të atyre të udhëtarëve apo qoftë të atyre të mallrave.

Sektori i komunikacionit ka punuar me një angazhim 24 (njëzetekatër) orësh për rregullimin dhe mbikëqyrjen e komunikacionit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave, duke u kujdesur që çdo gjë të jetë në nivelin e duhur dhe të zbatohet me përpikëri orari i lëvizjes së trenave.

Falë angazhimeve maksimale, gjatë këtyre tre muajve nuk kemi pasur asnjë vonesë apo anulim të qarkullimit të trenave për shkak të këtij departamenti. Për më tepër, çdo kërkesë e operatorëve të transportit hekurudhor TRAINKOS-it apo RAILTRANS-it për futjen në komunikacion të trenave të cilët nuk kanë qenë të paraparë me orar të lëvizjes së trenave dhe për të cilët janë kërkuar trase të jashtëzakonshme, është realizuar menjëherë.

Në mënyrë që të kemi një pasqyrim më të mirë të informatave dhe të dhënave rreth aktiviteteve të këtij sektori, në vijim janë prezantuar në formë tabelore të dhënat mbi lëvizjen e trenave, qasjen në binarë, të dhëna nga Terminali i mallrave dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme.

### 4.1.2 Numri i trenave

Prioriteti numër një i këtij sektori gjatë këtij viti ka qenë organizimi i qarkullimit të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave nëpër linjat hekurudhore.

Në tabelat vijuese janë paraqitur të dhënat mbi numrin e trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave të cilët kanë qarkulluar në vitin 2023, duke e bërë krahasimin e tyre me vitin 2022.

*Tabela 1. Trenat e trenave të udhetarëve*

| Krahasimi i trenave | Trenat e udhëtarëve | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Numri trenave të planifikuar | Trenat e rregullt | Trenat ad hok | Trenat e revokuar | Numri i trenave të realizuar |
| | *1* | *2* | *3* | *4=1-2* | *5=2+3* |
| Viti 2023 | 2190 | 2172 | 2 | 18 | 2174 |
| Viti 2022 | 2190 | 2189 | 4 | 1 | 2193 |
| Diferenca (2023-2022) | 0 | -17 | -2 | 17 | -19 |

*Tabela 2. Tabela e trenave të Mallrave*

| Krahasimi i trenave | Trenat e mallrave | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Numri trenave të planifikuar | Trenat erregullt | Trenat ad hok | Trenat e revokuar | Numri i trenave të realizuar |
| | *1* | *2* | *3* | *4=1-2* | *5=2+3* |
| Viti 2023 | 2212 | 315 | 238 | 1897 | 553 |
| Viti 2022 | 2336 | 35 | 233 | 2301 | 268 |
| Diferenca (2023-2022) | 878 | 280 | 5 | -404 | 285 |

Nga tabelat e mësipërme shihet se numri i trenave të udhëtarëve të cilët kanë qarkulluar në vitin 2023 është për 99 trena më i vogël se sa numri i trenave në vitin 2022, ndërsa sa i përket trenave të mallrave, situata është më e mirë, sepse në vitin 2023 ka pasur ngritje të qarkullimit të trenave të mallrave për 285 trena. Kërkesat për qarkullim të trenit kanë qenë të operatorit Trainkos në relacionin Drenas – Medvec – Drenas dhe në relacionin Maqedonia e veriut – Hani i Elezit – Miradi.

### 4.1.3 Shërbimi i qasjes në binarë

Shërbimi i qasjes në rrjet ka bërë me sukses përcjelljen e vazhdueshme të qarkullimit e të gjitha mjeteve lëvizëse nëpër rrjetin hekurudhor të INFRAKOS-it duke bërë llogaritjen dhe faturimin e pagesave të qasjes në binarë dhe e të gjitha shërbimeve tjera shtesë të cilat i ka ofruar INFRAKOS-i për operatorin e transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS.

Në tabelat vijuese është dhënë krahasimi i të hyrave për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 për operatorin TRAINKOS dhe atë RAILTRANS.

| Të hyrat nga qasja në rrjetin | Trenat e udhëtareve | Trenat e mallrave | Trenat ad hok | Shërbimet tjera | Të hyrat totale |
|---|---|---|---|---|---|

| hekurudhor | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2023 | 155,489.06 | 13,496.25 | 11,555.82 | 29,426.38 | 209,967.51 |
| Viti 2022 | 156,295.04 | 1,846.80 | 15,660.97 | 21,643.37 | 195,446.18 |
| Ndryshimi (2023 – 2022) | -805.98 | 11,649.45 | -4,105.15 | 7,783.01 | 14,521.33 |

*Tabela 3. Të hyrat nga qasja në binar e operatorit Trainkos*

Nga tabela e më sipërme shihet se në vitin 2023 të hyrat nga trenat e udhëtarëve kanë rritje për 11,649.45 € në krahasim me vitin 2022, ndërsa të hyrat nga trenat e mallrave kanë një rënie për 805.98 €. Trenat ad hok kanë një rënie prej 4,105.15€, për shërbimet tjera ka pasur ngritje të hyrave në vlerën prej 7,783.01 €. Në tërësi, të hyrat totale nga TRAINKOS-i në vitin 2023 janë për 14,521.33 € më të mëdha se sa ato në vitin 2022.

Të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet ka pasur vetëm nga operatori TRAINKOS-i, ndërsa nga operatori RAILTRANS të hyrat kanë qenë zero. Andaj në vijim është bërë paraqitja tabelore e të hyrave nga pagesat e qasjes në binarë për trenat e mallrave nga Operatori i Transportit RAILTRANS.

| Të hyrat nga qasja në rrjetin hekurudhor | Trenat e mallrave | Trenat ad hok | Shërbimet tjera | Të hyrat totale |
|---|---|---|---|---|
| Viti 2023 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Viti 2022 | 0.00 | 0.00 | 175.40 | 175.40 |
| Ndryshimi (2023 – 2022) | 0.00 | 0.00 | -175.40 | -175.40 |

*Tabela 4. Të hyrat nga qasja në binar e operatorit Railtrans*

### 4.1.4 Terminali i mallrave

Terminali i mallrave në Stacionin Hekurudhor në Miradi si i vetmi terminal në sistemin hekurudhor të Kosovës ku bëhet ngarkim shkarkimi i kontejnerëve dhe i mallrave tjera, në vitin 2023 ka qenë në dispozicion për realizim të kërkesave të tregut. Për kundër kapacitetit të tij realizimi i të hyrave nuk dallon shumë nga viti 2022.

*Tabela 5. Te hyrat nga terminali i mallrave*

| Të hyrat nga Terminali | Numri i kontejnerëve | Numri i vagonëve | Të hyrat nga krani | Të hyrat nga piruneri | Të hyrat nga fletëhyrjet | Totali i të hyrave |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2023 | 3 | 0 | 360,00 | 240.00 | 220.00 | 820.00 |
| Viti 2022 | 0 | 7 | 0 | 140.00 | 330.00 | 470.00 |
| Diferenca (2023 – 2022) | 3 | -7 | 360.0 | 100.00 | -90.00 | 350.00 |

### 4.1.5 Aksidentet hekurudhore

Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i aksidenteve hekurudhore të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2023, duke i krahasuar me vitin 2022.

*Tabela 6. Aksidentet hekurudhore*

| Rastet e jashtëzakonshme | Numri i aksidenteve | Aksidentet në vendkalime | Aksidentet në stacione dhe linjë të hapur | Vlera e dëmeve materiale në € | Auto të dëmtuara | Numri i personave të vdekur | Numri i personave të lënduar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2023 | 12 | 8 | 4 | 1700.20 | 9 | 1 | 7 |
| Viti 2022 | 8 | 6 | 2 | 100.00 | 7 | 0 | 8 |
| Ndryshimi (2023 - 2022) | 4 | 2 | 2 | 1600.20 | 2 | -2 | -1 |

Nga tabela shihet se në vitin 2023 kemi pasur gjithsejtë 12 raste të jashtëzakonshme, që krahasuar me vitin 2022 kemi katër raste të jashtëzakonshme më shumë. Në këto aksidente një person ka humbur jetën dhe shtatë persona të lënduar. Vlen të ceket se të gjitha rastet e jashtëzakonshme janë trajtuar nga komisioni profesional i përbashkët i INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it, gjithashtu është njoftuar edhe Komisioni për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore në kuadër të Zyrës së kryeministrit si dhe Policia e Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet se asnjëri prej rasteve të jashtëzakonshme të përmendura më lartë nuk ka ardhur si pasojë e INFRAKOS-it.

Si sektor, për kundër mungesës së madhe të stafit ekzekutiv që ka pasur, organizimi dhe udhëheqja e komunikacionit ka rezultuar me sukses.

## 4.2 Sektori për Mirëmbajtjen e Linjave Hekurudhore (MLH)

Gjatë vitit 2023, sektori i MHL-së është marrë me aktivitetet e mirëmbajtjes së linjave hekurudhore dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse në mënyrë që qarkullimi i trenave dhe mjeteve tjera lëvizëse të bëhet pa problem dhe me sigurinë maksimale. Sektori i MHL-së përkundër vështirësive financiare të kompanisë ka arritur që të ruaj një nivel të kënaqshëm në mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese hekurudhore, përfshirë këtu binarët hekurudhor me tërë infrastrukturën e tyre përcjellëse, urat, tunelet, lëshesat, kanalet ujë përcjellëse, platotë për ngarkim/shkarkimin e mallrave, vendkalimet në nivel, si dhe të gjitha objektet tjera për ofrimin e shërbimeve hekurudhore.



**Rregullimi i gjeometrisë së binarit** –Gjatë vitit 2023 është bërë kontrollimi i rregullt i hekurudhës dhe objekteve përcjellëse sipas planifikimit mujor duke u bazuar në rregulloret ekzistuese. Kontrollimet janë kryer si kontrollime vizuale të hekurudhës dhe objekteve nëpër linjat hekurudhore duke ecur dhe duke evituar mangësitë e identifikuara në kohë sa më të shkurtë. Një punë e madhe është bërë edhe në përcjelljen e gjendjes së binarëve, kështu që pas evidentimit të mangësive eventuale është bërë intervenimi i menjëhershëm me makineritë dhe personelin e mirëmbajtjes për evitimin e të gjitha prishjeve duke e bërë rregullimin e binarëve sipas standardeve të kërkuara.



Të gjitha këto punë janë realizuar në linjën hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardh – Medvec dhe janë punuar gjithsejt 25 km e 500 m.

### 4.2.1 Mirëmbajtja dhe kontrollimi i ndërrueseve

Sektori për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore gjatë muajit e bënë tri herë kontrollimin vizual të ndërrueseve dhe një herë me matje, po ashtu një herë në muaj bëhet kontrollimi teknik i ndërrueseve ku në këtë kontrollim

përveç sektorit MLH-së janë prezent edhe Sektori i Veprimtarisë Elektroteknike dhe Sektori i Komunikacionit. Gjatë këtij viti përveç kontrollimit është bërë edhe mirëmbajtja e ndërrueseve në të gjitha linjat qe kanë qenë në funksion.



## 4.2.2 Rregullimi i ndërrueseve sipas kahes dhe niveletës

Në këtë pozicion të punëve bëhet rregullimi i deformimeve të kahes dhe niveletës, pjesëve të dëmtuara dhe rregullimi i koltrinës - ballastit nëpër ndërruese të stacioneve hekurudhore dhe ndërrueseve në linjë të hapur.

Këto punë janë kryer me makinë Plasser dhe me fuqi punëtore. Një mirëmbajtje e tillë e garanton qarkullimin e sigurt të trenave të udhëtarëve dhe mallrave. Gjatë viti 2023 është punuar në Linjën Hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë, Bardhë - Medvec dhe janë punuar gjithsej 24 ndërruese.



## 4.2.3 Ndërrimi i traversave të vjetruara në ndërruese dhe linjë të hapur

Në mënyrë që të garantohet siguria e qarkullimit të trenave njësitë e mirëmbajtjes së binarëve në mënyrë të vazhdueshme kanë bërë kontrollimin e linjave hekurudhore dhe pas verifikimeve në teren është bërë zëvendësimi i traversave të vjetërsuara. Ndërrimi i traversave është bërë nëpër ndërrueset e linjës hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë, ku janë ndërruar gjithsej 79 traversa me dimensione të ndryshme.





### 4.2.4 Ndërrimi i shinave me kokë të konsumuar nëpër kthesa

Shinat për shkak të fërkimit më të madhë në kthesa konsumohen dhe në këtë mënyrë rrezikohet siguria e qarkullimit të trenave. Për këtë arsye njësitë e mirëmbajtjes së linjave hekurudhore gjatë tërë vitit kanë bërë inspektimin e shinave dhe varësisht nga dëmtimi është bërë menjëherë zëvendësimi i tyre.



Ndërrimi i shinave me kokë të konsumuar është bërë në kthesë në km 37+200 – 530 në Linjën Hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë në mes stacionit Drenas – Klinë, nën mbyllje të komunikacionit hekurudhor. Gjithsej janë ndërruar 330 metra shina.



### 4.2.5 Pastrimi dhe rregullimi i zonave të vendkalimeve në nivel

Në këtë pozicion të punës përfshihet mirëmbajtja, nivelimi dhe pastrimi i vendkalimeve në nivel hekurudhë – rrugë. Këtu është bërë një punë e madhe, sidomos në rregullimin e shiritit kalues të automjeteve në zonën e vendkalimeve. Gjatë këtij viti është bërë rregullimi dhe mirëmbajtja e zonave të këtyre vendkalimeve në drejtim të ngritjes së kushteve teknike dhe sigurisë për qarkullimin e trenave.



Një punë e madhe është bërë edhe në pastrimin dhe rregullimin e profilit të lirë dhe këndit të dukshmërisë.

Gjatë viti 2023 është bërë pastrimi dhe rregullimi i konstruksionit te vendkalimeve në Linjën Hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardhë – Medvec .Gjatë këtij viti janë pastruar 232 vendkalime dhe është bërë rregullimi i 26 vendkalimeve.



### 4.2.6 Rrënimi i vendkalimeve ilegale

Njëri ndër problemet kryesore gjatë këtyre viteve ka qenë dhe mbetet ndërtimi i vendkalimeve ilegale nga persona të papërgjegjshëm. Kjo ka ndodhur edhe gjatë vitit 2023, ndërsa si zakonisht sektori i MLH-së për secilin rast ka intervenuar menjëherë duke e bërë rrënimin e këtyre vendkalimeve por në të njëjtën kohë duke e njoftuar Policinë e Kosovës dhe zyrën ligjore për përgatitjen e padive.

Në këtë periudhë kohore është bërë rrënimi i vendkalimit të vendosur në km 29+100 të Linjës Hekurudhore Fushë Kosovë - Pejë ndërmjet stacionit Drenas – Banjic, rrënimi i vendkalimit ilegal në km 16+400 në mes stacionit Bardhë – Drenas dhe rrënimi i vendkalimit ilegal në km 79+100 ndërmjet stacionit hekurudhor Klinë Pejë.



### 4.2.7 Mirëmbajtja, pastrimi dhe rregullimi i kanaleve ujë përcjellëse dhe lëshesave

Sektori i MLH-së ka bërë pastrimin e kanaleve anësore dhe lëshesave aty ku është vlerësuar se duhet ndërhyrë në linjat hekurudhore në mënyrë që gjatë reshjeve atmosferike të mos vjen deri te vërshimi i binarëve hekurudhor.



Gjatë viti 2023 është bërë pastrimi dhe rregullimi i kanaleve ujë përcjellës dhe lëshesave në Linjën Hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardhë – Medvec. Gjatë këtij viti janë pastruar 483 m kanal dhe 8 lëshesa.



### 4.2.8 Pastrimi i profilit të lirë

Në vitin 2023 është bërë pastrimi i vazhdueshëm i profilit të lirë, në të gjitha linjat hekurudhore ku janë duke operuar trenat ashtu që linjat hekurudhore të garantojnë sigurinë maksimale të qarkullimit të trenave. Sektori i MLH-së ka një përvojë të gjatë dhe ekspertizë të mjaftueshme për realizimin e mirëmbajtjeve të tilla dhe kjo bëhet sipas standardeve dhe rregulloreve në fuqi dhe gjatë kësaj periudhe janë pastruar gjithsej 16 km e 125m.



### 4.2.9 Tharja e barojave

Problem evident për linjat hekurudhore paraqesin barojat. Gjatë muajit Maj - 2023 është bërë pastrimi dhe spërkatja e barishtave në linjën hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardhë – Magure.

## 4.2.10 Kontrollimet e hekurudhës dhe objekteve përcjellëse

Gjatë viti 2023 është bërë kontrollimi i gjendjes së shtresës së ultë dhe shtresës së lartë në Linjen Hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardhë – Medvec me shikim vizual ,matje , dhe nga mjetet lëvizëse,me ç'rast janë vërtetuar: parametrat teknik të linjës,rregullimi i binarit dhe rregullsia e materialit të binarit dhe objekteve të shtreses së ultë. Të gjitha parregullësit e konstatuara gjatë kontrollimit nga ana e udhëheqësit të Sektorit,Shefit të shërbimit dhe Shefave të njësive të MLH-së janë eliminuar me kohë dhe në afet sa ma të shkurtë të mundshëm.



## 4.2.11 Mirëmbajtja e binarëve Industrial

Është bërë mirëmbajtja e binarit Industrial Ferronikeli prej datës 25.09.2023 – 01.11.2023 ku pastaj janë ndërprerë punimet sipas kërkesës së Ferronikelit për shkak të ndërprerjes së prodhimit. Gjatë kësaj kohe janë punuar 2255 metra rregullim të binarit sipas kahes dhe niveletë, matja e binarit dhe ndërrueseve 1300 m, janë mirëmbajtur dhe pastruar 2 nënkalime dhe është bërë vajosja dhe përpunimi i 500 copë bulonave. Vlera e këtyre punëve të kryera për ketë periudhë ka qenë 15,278.85 € me TVSH .

## 4.2.12 Lyerja dhe përpunimi i bulonave

Lyerja dhe përpunimi i bulonave në periudhën Janar-Mars dhe në muajin dhjetor 2023 është bërë nëpër ndërruese, binar të stacioneve dhe tunele.





## 4.2.13 Planifikimi i koltrinës - ballastit

Planifikimi i koltrines – ballastit është bërë në linjë të hapur dhe nëpër ndërruese. Planifikimi është bërë me makinën Plasser SSP 103 dhe me fuqi



punëtore. Gjatë vitit 2023 është punuar në Linjën Hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë, Bardhë - Medvec dhe janë punuar gjithsej 63 km e 230 m.

### 4.2.14 Pastrimi i gurëve nga tereni me pjerrësi të mëdha dhe prerjet e terenit

Është bërë pastrimi i gurëve nga tereni me pjerrësi të mëdha dhe nga prerjet e terenit. Pastrimi i gurëve nga tereni me pjerrtësi të mëdha është bërë kryesisht në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë ndërmjet stacionit hekurudhor Drenas – Klinë.



### 4.2.15 Pastrimi i akullit dhe bores nëpër ndërruese, vendkalime dhe tunele

Gjatë sezonit dimëror është bërë pastrimi i akullit dhe borës nëpër ndërruese në të gjitha linjar hekurudhore te cilat janë në shfrytëzim.





### 4.2.16 Vëzhgimi i rregullt binarit dhe gjatë kohës me temperatura të larta

Gjatë viti 2023 është bërë vëzhgimi i binarit në linjën hekurudhore Klinë - Xërxë – Prizren dhe kohë pas kohe në linjën hekurudhore Podujevë – Prishtinë.

Sektori i MLH-së gjatë tërë periudhës kohore me temperatura të larta përmes punëtorëve me njohuri të duhur profesionale në cilësi të rojtarëve të nxehtësisë në mënyrë permanente e kanë bërë vëzhgimin e linjave hekurudhore që në rast të lajmërimit të ndonjë çrregullimi nga të ashtuquajturat ,,kthesa të diellit" të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për parandalimin dhe eventualisht

mënjanimin sa më të shpejtë të këtyre çrregullimeve të binarit dhe krijimin e para kushteve për zhvillim të sigurt të komunikacionit hekurudhorë.

Në periudhën kohore me temperatura të larta prej muajit Gushtë deri në muajin Shtator është bërë vëzhgimi i binarit për shkak të temperaturave të larta. Vëzhgimi është bërë në Linjën Hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardhë - Medvec. Gjatë kësaj kohe kemi pasur deformim të binarit në km 63+200 – 800 dhe u vendos shpejtësia e ngadalësuar e përkohshme sepse në të njëjtën ditë gjatë natës është intervenuar me makinen Plasser dhe është bërë rregullimi i binarit me çka edhe është bërë eliminimi i shpejtësisë së ngadalësuar.

Përveç angazhimit të lartpërmendur, ky sektor ka kryer edhe pune tjera, si:

- Përgatitjen e specifikacioneve teknike për projektet e parapara si dhe për furnizim me material;
- Mbikëqyrja dhe udhëheqja e projekteve;
- Mirëmbajtja e makinave Plasser;
- Mirëmbajtja e objekteve dhe nyjave sanitare
- Thyerja, ngarkim, transporti dhe shkarkimi i thëngjillit;
- Bartja e shinave të rrethojës në Miradi;
- Ngarkimi i hirit me Ekskavator;
- Rregullimi i ndërrueseve me makinën Plasser për nevoja të GCF;
- Pastrimi i mbeturinave nga binari Bardh – Magurë;
- Pastrimi i drunjëve nga binari në linjë të hapur hekurudhore Fushë Kosovë – Prishtinë së bashku me zjarrfikësit;
- Pastrimi në ish restorantin e punëtorëve në ndërtesën e drejtorisë;
- Rregullimi i vazhdimeve klasike;
- Mirëmbajtja e makinave Plasser;
- Shkruarja e shenjave kilometrike nëpër vendkalime;
- Përgatitja e kioskës dhe vendosja te parkingu afër stacionit hekurudhor në Fushë Kosovë.

## 4.3 Sektori i Veprimtarisë Elektroteknike

]Sektori i veprimtarisë elektroteknike ka arritur me sukses realizimin e objektivave të parapara me Planin e Veprimit i cili është përgatitur në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2023. Ky sektor gjatë tërë vitit ka bërë mirëmbajtjen e pajisjeve SS, TK, EN dhe ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme, evitim të shpejtë të pengesave duke intervenuar edhe jashtë orarit të punës në mënyrë që të mos ketë probleme gjatë qarkullimit të trenave.

Objektivat e sektorit të VE-së janë:

- Ngritja e sigurisë së komunikacionit hekurudhor;
- Mirëmbajtja e rregullt dhe funksionale e vendkalimeve në linjën hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë;

Meqenëse pajisjet sinjalo siguruese (SS), telekomunikuese (TK) dhe ato të energjetikës (EN) janë të shtrira në rrjetin hekurudhor, në vazhdimësi këto pajisje kenë probleme të ndryshme për shkak të ndikimeve të palëve të treta mbi këto pajisje.

Gjatë tërë vitit, të gjitha shërbimet e këtij sektori kanë arritur me sukses ti realizojnë detyrat e parapara, përfshirë pajisjet sinjalo siguruese, telekomunikuese të energjetikës dhe ato të IT edhe pse në kushte të vështira, për shkak të pamjaftueshmërisë së pjesëve rezervë, pajisjet gjatë gjithë kohës kanë qenë në funksion të plotë.

- Përcjellja e Projektit për Rehabilitim të hekurudhës;
- Furnizim me pjesë rezervë për vendkalime;
- Shpenzimet buxhetore në sektor (Janar - Dhjetor 2023).

Për shkak të punimeve ndërtimore në rehabilitim të linjës hekurudhore janë shkyçur sistemet SS në stacionet në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit dhe në linjën Fushë Kosovë - Mitrovicë. Këto sisteme të stere vjetruara nuk mund të kthehen më në përdorim, sigurimi i këtyre stacioneve, deri në instalimin e sistemeve të reja, do të bëhet në mënyrë manuale dhe bazuar në rregulloren e komunikacionit në rastet kur sinjalet nuk punojnë.

Lloji i intervenimeve për eliminimin e pengesave dhe disa nga detyrat kryesore të realizuara në këtë periudhë kohore janë renditur në vijim:

- Ka bërë evitimin e shpejtë të pengesave në teren duke intervenuar nëpër sistemet ekzistuese në vendkalime hekurudhore (VK), në sistemet e TK, EN dhe TI edhe jashtë orarit të punës;
- Ekipet profesionale kanë punua në mirëmbajtje të pajisjeve SS,TK dhe EN duke i mbajtur ato me vështirësi në gjendje të mirë funksionale për shkak të vjetërsisë së tyre (mbi 30 vite të vjetra);
- Është bërë kontrollimi mujor i ndërrueseve së bashku me sektorin e komunikacionit dhe MLH-së nëpër linjat hekurudhore në operim;
- Sipas zhvillimeve të punëve ndërtimore të Projektit për Rehabilitim të linjës 10 hekurudhore me kërkesë të PIU kemi asistuar në teren;
- Është përcjellë puna e VK –ve automatike përgjatë linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë;
- Është bërë furnizimi me material elektrik, për telekomunikim dhe për energjetikë;
- Nga operatori ekonomik është bërë instalimi i 5 klimave në stacionet Prishtinë, Bardh, Drenas, Klinë dhe Pejë;
- Mirëmbajtja e pajisjeve të brendshme elektroreleike si dhe pajisjeve të furnizimit me tension

duke bërë zëvendësimin e elementeve të prishura;
- Riparimi i defekteve në antenat e sistemit të radiolidhjeve;
- Evitimi i vazhdueshëm i pengesave në sistemin e telefonisë nëpër zyra dhe stacionet hekurudhore;
- Instalimi, mirëmbajtja dhe evitimi i pengesave në video sistemin e vrojtimit të stacioneve;
- Eliminimi e pengesave në sistemin energjetik, përfshirë këtu, rrjetin e ndriçimit, instalimet elektrike, trafo stacionet, gjeneratorë, shtrirjen e kabllove energjetike, si dhe mirëmbajtja e vazhdueshme teknike e objekteve;
- Testimi i kabllove optike dhe evitimi i problemeve;
- Mirëmbajtje e rregullt efektive e pajisjeve dhe rrjetës së Teknologjisë Informative;
- Ngritja e nivelit të sigurisë së sistemit të Teknologjisë Informative;
- Janë montuar, instaluar dhe konfiguruar pajisje kompjuterike sipas nevojës dhe kërkesave të zyrtarëve të Infrakos-it;
- Është intervenuar në evitim të problemeve energjetike të paraqitura;

## 4.4 Sektori për Planifikim, Zhvillim, Standardizim dhe Siguri

Sektori për PZHSS, gjatë vitit 2023 ka bërë hapa të rëndësishëm në avancimin e planifikimit dhe zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë, nëpërmjet përpjekjeve bashkëpunuese me aktorë të ndryshëm, ka zbatuar dhe përmirësuar me sukses standardet për të garantuar sigurinë dhe efikasitetin e rrjetit hekurudhor.

Aktivitetet kryesore dhe rezultatet e arritura janë paraqitur në vijim:

- Ofrimin e mbështetjes profesional në realizimin e kërkesave të ndryshme në nivel të kompanisë dhe detyrave të dala nga mbledhjet e menaxhmentit;
- Është hartuar koncepte dokumenti për rregullimin e hapësirave dhe sinjalizimin horizontal edhe vertikal për stacionin hekurudhore në Fushë Kosovë;
- Është hartuar dhe dërguar shkresa për vendosjen e sinjalizimit për sigurimin e vendkalimeve në nivel rrugë-hekurudhë për gjitha komunat ku graviton hekurudha;
- Hartimi i një koncepte dokumenti mbi gjendjen aktuale edhe evidentimin e eksponateve në "Muzeun e Hekurudhave të Kosovës" edhe mundësin e regjistrimit si muze industrial i Kosovës;
- Ka hartuar analizën e konsumit të energjisë për ngrohje në stacionet hekurudhore në Prishtinë dhe Fushë Kosovë;
- Ka përgatitur dokumentin për sfidat në zbatimin e projekteve të përcaktuar në Planin Kombëtarë Zhvillimor të Kosovës (PZhK);

- Mbështetja profesionale për pjesën sa i takon Infrakos-it për zbatim të projektit "Vlerësimi i tregut hekurudhor në Ballkanin Perëndimor për sa i përket kapaciteteve, politikave, nivelit ekonomik dhe teknik të zhvillimit të segmenteve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve", nga Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit (TCPS);
- Mbështetja profesionale për pjesën sa i takon Infrakos-it për përpilimin e "Koncept Dokumentit" për plotësim ndryshimin e Ligjit për hekurudha dhe Ligjit të ri për Siguri dhe Interoperbilitetin hekurudhor;
- Kontribut profesional në hartën zonale të Komunës së Obiliqit, Lipjanit;
- Është hartuar një letër kërkesë për vendosjen e sinjalizimit horizontal edhe vertikal në sheshin e Lirisë Fushë Kosovë;
- Është hartuar një letër kërkese për Komunën e Klinës për trajtim urgjent të vendkalimin në kilometrin hekurudhor 55+698 në Klinë, rruga kryqëzohet me linjën hekurudhore;
- Është ri plotësuar PSO-ja për Qendrën e trashëgimisë kulturore në Prishtinë për stacionin hekurudhor në Drenas dhe Pejë;
- Është realizuar dhe përgatitur dokumentacionin për të diskutuar potencialin e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve tona për ndërtimin e linjës hekurudhore Aeroport - Prishtinë.
- Është përditësuar tabela sipas kërkesës së TODIS-it;
- Jemi angazhuar në hartimin e përgjigjeve dhe dokumenteve për zyrën e prokurimit për përgjigjet e parashtruar nga operatoret ekonomik për Dizajnin preliminar të linjës hekurudhore Fushë Kosovë Klinë –Prizren- Pejë lidhur me objektet dhe linjën e cila është nën mbrojtje të përkohshme të trashëgimisë kulturore;
- Është angazhuar në hartimin e listës përfundimtare për vendkalime hekurudhore në nivel për programin "Jaspers" ;
- Angazhim në hartimin e përgjigjeve të kërkesave nga Qendra për Trashëgimi Kulturore Prishtinë;
- Kontribut profesional në draftin e ligjit për muzetë respektivisht për muzetë industrial ku është paraparë edhe muzeu i hekurudhave;
- Është hartuar letër formulari i standardizuar për shitjen e traversave dhe shinave.
- Është hartuar Raporti Vjetor i Sigurisë;
- Është marrë me hartimin, zhvillimi, dhe vendosjen e sistemit të integruar në këtë kontekst edhe të SMS-të, duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm, si dhe ka realizuar të gjitha kërkesat të cilat janë kërkuar nga menaxhmenti dhe vetë KE i Infrakos-it;
- Është punuar drafti fillestar i Manualit të SIM;
- Është hartuar drafti i aplikacionit për grand të ËBIF, për projektin e Studimit të Fizibilitetit dhe të Dizajnit Detal për linjën hekurudhore e cila lidhë Kryeqytetin Prishtinën me

Aeroportin Ndërkombëtarë "Adem Jashari";
- Angazhimi në grupe punuese dhe komisione profesionale.

## 4.5 Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës ka zhvilluar e saj edhe gjatë vitit 2023 për të përmbushur objektivat sipas Planit të Biznesit dhe Planit të Veprimit të kompanisë.

Në secilin sektor dhe shërbim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara me Planin e Biznesit për vitin 2023.

Sektori i Personelit i ka përmbushur me sukses detyrat e parapara duke bërë administrimin e personelit në mënyrë shumë të mirë, me synim drejt arritjes së objektivave.

Shërbimi i Shkrimores dhe Arkivit edhe gjatë këtij viti janë angazhuar me të gjitha kapacitetet njerëzore dhe profesionale për arritjen e objektivave të parapara.

Shërbimi i Logjistikës ka bërë mirëmbajtjen e automjeteve dhe menaxhimin e tyre sipas rregulloreve në fuqi. Sa i përket pastërtisë dhe higjienës në tërësi ka pasur vështirësi për shkak të gjendjes së vështirë financiare gjë që ka ndikuar edhe në furnizimin me material për pastrim.

Shërbimi i Mirëmbajtjes është angazhuar suksesshëm në përmbushjen e detyrave të punës duke bërë mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve, pajisjeve përcjellëse të tyre dhe hapësirave të kompanisë në tërësi.

Përfundimisht, objektivat nga plani i biznesit i Departamentit të Administratës janë përmbushur për vitin 2023 nga të gjithë sektorët dhe shërbimet përkatëse.

## 4.6 Sektori i resurseve njerëzore

Sektori i resurseve njerëzore ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar edhe gjatë vitit 2023 në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij sektori dhe departamentit në tërësi. Në secilin fushëveprim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara dhe kjo është arritur me mjaft sukses.

Në janar të vitit 2023 INFRAKOS-i kemi startuar me 251 punonjës të rregullt ndërsa në muajin dhjetor të vitit 2023 kanë mbetur 232 punonjës të rregullt ndërsa edhe një punëtorit pensionist iu është vazhduar puna me vendim të veçantë për shkak të specifikave për një periudhë të caktuar.

Pra, gjithsejtë i kemi 233 punonjës aktiv duke e përfshi edhe Bordin e Drejtorëve 237.

Pas lëvizjeve të ndryshme siç janë largimi, vdekjet dhe pensionimi,

lëvizje këto që janë bërë brenda periudhës prej një viti, janë rreth 20 punonjës

Struktura e të punësuarve në fund të vitit 2023 varësisht nga kategoritë e ndara më poshtë është si vijon:

- Punonjës me marrëdhënie të rregullt të punës janë 233 prej të cilëve 229 ose 92% kanë kontrata pune në afat të pa caktuar, ndërsa mosha mesatare është rreth 50 vjeç.
- Meshkuj janë 209 të punësuar dhe përbëjnë 92% nga totali i të punësuarve
- Femra janë 17 të punësuara dhe përbëjnë 6.6% nga totali i të punësuarve.
- Shqiptarë janë 226 të punësuar dhe përbëjnë 97% nga totali i të punësuarve
- Serb janë 6 të punësuar dhe përbëjnë 2.37% nga totali i të punësuarve
- Ashkalinjë dhe rom janë 1 të punësuar dhe përbëjnë 0,39% nga totali i të punësuarve
- Me shkollë fillore ose të kualifikuar nga Hekurudhat kemi gjithsejtë 33 punëtorë
- Me shkollë të mesme kemi gjithsejtë 131 punonjës
- Me shkollë të lartë kemi gjithsejtë 6 punëtorë dhe
- Me shkollim superior kemi gjithsejtë 64 punëtorë

### 4.6.1 Përmbushja e objektivave nga plani i biznesit për vitin 2023

Sektori i resurseve njerëzore sikurse çdo sektor tjetër i kompanisë, prioritetin numër një e ka pasur

- Menaxhimi i rregullt i resurseve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi);
- Pagat dhe kompensimet tjera të punonjësve;
- Disiplina në punë;

Vlen të ceket se falë angazhimit të këtij sektori, të gjitha objektivat e realizimin e objektivave të parapara me planin e biznesit. Objektivat e këtij sektori kanë qenë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punonjësit dhe palët e Interesuara; dhe
- Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore.

parashtruara më sipër gjatë vitit 2023 janë realizuar me sukses.

### 4.6.2 Shërbimi i Shkrimores dhe arkivit

Shërbimi i Shkrimores dhe arkivit gjatë kësaj përudhe ka organizuar dhe mbikëqyrë punët dhe detyrat e realizuara në këtë shërbim, vlen të theksohet se është bërë rregullimi, regjistrimi dhe sistemimi i lëndëve arkivore sipas standardeve dhe ligjit. Por ende mbetet punë për tu bërë në objektin ku janë të vendosura lëndët arkivore nga vitet e kaluara. Në

protokollin e punës të shkrimores së INFRAKOS-it brenda muajve Janar – Dhjetor 2023 janë arkivuar këto lëndë:

- Kërkesa hyrëse janë: 388
- Lëndët nga gjykata : 259
- Fatura hyrëse: 1217
- Lëndët e punuara brenda dhe shpërndara jashtë: 740
- Lëndët punuara brenda dhe shpërndara brenda : 492
- Dërgesa me postë: 191
- Kontrata për dhënien e pronës me qira :234
- Aneks kontrata për dhënien e pronës me qira; 14
- Kontrata pune : 196
- Aplikacione për dhënien e pronës me qira :45
- Aplikacione për pozita rekrutuese : 65

### 4.6.3 Shërbimi i logjistikës

Shërbimi i Logjistikës ka zhvilluar aktivitetet e saj edhe gjatë vitit 2023 për të përmbushur objektivat e këtij shërbimi, duke punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara.

Shërbimi i logjistikës ka punuar po ashtu në mirëmbajtjen e automjeteve rrugore të kompanisë, duke përcjellë gjendjen e tyre ditore dhe duke bërë e bërë kontrollimin e lëvizjes së tyre.

Më poshtë e keni tabelën e shpenzimeve për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ku shihet se edhe në këtë kategori të shpenzimeve kemi pasur reduktim të shpenzimeve.

*Tabela 7. Shpenzimet e sherbimit të logjistikes*

| Periudha kohore | Kilometrat e kaluara | Derivatet e shpenzuara në litra |
|---|---|---|
| Janar –Dhjetor 2022 | 98886 | 8830 |
| Janar –Dhjetor 2023 | 99095 | 8409 |
| Diferenca (2022 – 2023) | 791 | 421 |

Në kuadër të shërbimit të logjistikës funksionon edhe njësia e pastrimit të objekteve e cila gjatë vitit 2023 i ka realizuar me sukses të gjitha punët dhe detyrat e parashtruara, duke bërë pastrimin e të gjitha zyrave dhe ambienteve tjera të kompanisë, por një punë voluminoze është bërë edhe në pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të jashtme të INFRAKOS-it të cilat ndodhen përreth ndërtesave dhe objekteve tjera në pronësi të kompanisë.

### 4.6.4 Shërbimi i mirëmbajtjes së objekteve

Shërbimi për mirmbajtjen e objekteve e ka zbatuar me sukses planin e veprimit për vitin 2023, por në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm shpeshëherë ka pasur probleme me furnizim me pajisje dhe material për riparimin e objekteve dhe pajisjeve të caktuara.

**Nxehja qendrore** – Shërbimi i mirëmbajtjes se objekteve të cilët kanë qenë të angazhuar edhe në nxehjen qendrore në këtë periudhë të fund vitit 2023 nuk kanë qenë të angazhuar në këtë aktivitet për shkak të mos furnizimit me thengjill

**Riparimi i objekteve** – Në vitin 2023 është bërë rregullisht mirëmbajtja dhe rregullimi i objekteve. Përkundër buxhetit jo të mjaftueshëm, është arritur që disa prej objekteve të nevojshme të INFRAKOS-it të jenë funksionale dhe të ofrojnë kushtet e nevojshme për një ambient të mirë të punës.

Përfundimisht, përkundër sfidave tejet të mëdha departamenti i administratës gjatë vitit 2023 ka arritur t'i përmbushë shumicën e objektivave të parapara me Planin e Biznesit gjithnjë duke iu falënderuar angazhimit dhe përkushtimit e të gjithë punonjësve të këtij departamenti.

## 4.7 Sektori për pronë dhe standarde

Sektori për pronë dhe standarde ka pasur një angazhim maksimal gjatë tërë vitit 2023, duke pasur për bazë planin e veprimit të kompanisë dhe realizimin e objektivave të parapara. Angazhimi i këtij sektori ka qenë maksimal, andaj edhe nuk ka munguar as rezultati i pritur.

## 4.8 Sektori i patundshmërisë

Njëri ndër sektorët më të rëndësishëm për krijimin e të hyrave sekondare për INFRAKOS-in është sektori i patundshmërisë i cili merret me menaxhimin e pronës së kompanisë. Angazhimi i përhershëm i këtij sektori ka qenë i orientuar në plotësimin e kërkesave të klientëve tanë, si dhe në ngritjen e të hyrave për INFRAKOS-in. Falë angazhimeve ditore në mënyrë permanente të këtij sektori, nuk kanë munguar as rezultatet e pritura.

Sektori i pronës ka qenë një ndër sektorët me të rëndësishme qe ka ndikuar në rezultatin pozitiv të Infrakos-it për vitin 2023 duke i marrë veprimet e duhura kanë filluar të dalin rezultate të mira të cilat kanë rezultuar dhe ka pasur ndikim shumë të suksesshëm në përmirësimin e të hyrave nga prona.

Gjatë këtij viti përveç punëve të përditshme sektori është ballafaquar edhe me disa probleme tjera ku një numër i madh i shfrytëzuesve të

pronës kanë pasur borxhe të akumuluara në vite, andaj borxhlinjve më të mëdhenj u është ndërprerë kontrata, ndërsa në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të kompanisë janë marrë të gjitha masat juridike për lirimin e pronës duke i dërguar lëndët nëpër gjykata, ndërsa sa i përket borxheve të papaguara lëndët janë dërguar në përmbarim për ekzekutimin e borxheve të cilat shfrytëzuesit e pronës së INFRAKOS-it nuk i kanë paguar.

Një punë shumë e mirë është bërë edhe me zbatimin e rregullores së re mbi pronën, rregullore kjo e cila e përcakton në detaje mënyrën e menaxhimit të pronës duke filluar nga publikimi i shprehjes së interesit për dhënien e pronës me qira e deri të nënshkrimi i kontratës. Pra, INFRAKOS-i ka përzgjedhur që procedurat e dhënies së pronës me qira të bëhen në mënyrën më transparente të mundshme duke iu ofruar të gjithë klientëve kushte të barabarta të konkurrimit dhe shfrytëzimit të pronës për nevoja komerciale.

Përgjatë vitit 2023 në formë tabelore janë të paraqitura në mënyrë statistikore të gjitha kontratat, aneks kontratat, kontratat në procedurë shprehjet e interesit etj.

*Tabela 8. Kontratat dhe aneks kontratat nga sektori i prones*

| Permbajtja | Obliq | Vushtrri | Mitrovicë | Bardh I Madh | Drenas | Klinë | Pejë | Xërxë | Krush | Prizren | Miradi | Fushë Kosovë | Hani Elezit | Kaçanik | Ferizaj | Lypjan | Vranidoll | Prishtinë | Prelluzh / Leposavic | Podujevë | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kontratat e bizneseve vazhduese | 2 | 0 | 12 | 6 | 9 | 6 | 49 | 7 | 0 | 17 | 6 | 27 | 1 | 12 | 21 | 7 | 0 | 11 | 0 | 2 | 195 |
| Kontratat e bizneseve te reja | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 9 | 11 | 0 | 1 | 0 | 2 | 16 | 0 | 5 | 7 | 0 | 0 | 6 | 2 | 0 | 62 |
| Aneks kontratat e bizneseve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 2 | 0 | 2 | 1 | 3 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 14 |
| Kontratat e banesave vazhduese | 4 | 1 | 22 | 0 | 3 | 3 | 1 | 0 | 2 | 2 | 0 | 5 | 5 | 9 | 1 | 2 | 3 | 7 | 5 | 2 | 77 |
| Kontratat e banesave te reja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8 |
| Aneks kontratat e banesave | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Totali i Kontratave, aneks kontratave për biznese dhe banesa | 8 | 1 | 35 | 6 | 12 | 19 | 66 | 9 | 3 | 21 | 9 | 55 | 6 | 26 | 32 | 11 | 3 | 25 | 7 | 4 | 358 |
| Kontrata në procedurë janë: | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Kerkesa per nderprerje te kontrates | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 1 | 0 | 4 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 12 |
| Kerkesa per prona janë: | 8 | 0 | 5 | 2 | 2 | 15 | 28 | 6 | 0 | 15 | 4 | 38 | 2 | 8 | 12 | 3 | 2 | 9 | 1 | 3 | *163* |
| Pëlqime | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 11 | 1 | 0 | 10 | 0 | 7 | 1 | 1 | 6 | 1 | 0 | 2 | 1 | 1 | *48* |
| Refuzime | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 2 | *15* |
| Opinjone për kontratë, shpallje publike dhe procedur gjyqësore | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 | 9 | 0 | 0 | 2 | 1 | 16 | 0 | 5 | 4 | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 | *49* |
| Shkresa K.K per nderhyrje, Njoftimet per kryerjen e borxheve, kerkesa per historjat te prones, fletave poseduese- certifikate te prones. | 3 | 1 | 9 | 1 | 9 | 2 | 49 | 0 | 1 | 7 | 1 | 25 | 3 | 9 | 18 | 12 | 0 | 11 | 0 | 8 | *169* |
| Propozime per zyrës ligjore për permbarues dhe lirim prone (uzurpime) | 2 | 0 | 7 | 1 | 2 | 6 | 31 | 0 | 0 | 5 | 0 | 12 | 3 | 4 | 2 | 0 | 1 | 3 | 0 | 3 | *82* |

| Përshkrimi | Nr. i kontratave |
|---|---|
| Nr. i kontratave të reja | 69 |
| Nr. i aneks kontratave | 15 |
| Nr. i kontratave ne Procedurë | 6 |

| | |
|---|---|
| Nr. i Uzurpimeve | 89 |
| Nr. i lendeve ne zyrën ligjore | 82 |
| Nr. i kontratave vazhduese | 272 |
| Total i kontratave dhe aneks kontratave | 356 |

## 4.9 Zyra Ligjore

Sektori ligjor gjatë vitit 2023 ka vazhduar me përfaqësimin e kompanisë në procedurat ligjore, janë ofruar këshilla ligjore, opinione, ka marr pjesë në hartimin e akteve juridike të ndërmarrjes dhe ka asistuar në punët e rregullta të kompanisë

- Në fund të vitit 2023 në procedura ligjore janë: 388 lëndë aktive, (Nga të cilat, në 318 jemi paditës dhe në 70 jemi të paditur); 78 lëndë të reja (nga të cilat, në 71 jemi paditës dhe 7 të paditur) si dhe 18 raste kanë përfunduara (nga të cilat, 16 në favor dhe 2 në disfavor të ndërmarrjes).
- Në procedurë përmbarimore në fund të vitit janë: 214 lëndë aktive ( nga të cilat në 195 raste jemi kreditor kurse në 19 raste jemi debitor); 29 lëndë të reja ( nga të cilat 27 janë iniciuar nga Infrakos – jemi kreditor dhe 2 jemi debitor); 14 lëndë kanë përfunduara (nga të cilat 8 janë në favor të kompanisë dhe 6 në disfavor) si dhe 4 raste janë të pezulluara në mungesë te dhënave.
- Të gjitha propozimet për inicim të procedurave ligjore që janë paraqitur nga sektori i pronës dhe jo vetëm, janë trajtuar dhe janë iniciuar procedurat ligjore.
- Gjatë vitit janë mbajtur 142 seanca gjyqësore dhe është punuar në përgatitjen e lëndëve dhe parashtresave të ndryshme ligjore.
- Nga gjykata kanë arritur 71 vendime gjyqësorë, nga të cilat 49 apo 69 % janë në favor të Infrakos, ndërsa 22 raste apo 31% janë në disfavor të Infrakos.
- Në procedurë përmbarimore gjatë kësaj periudhe janë iniciuar 27 raste përmbarimore në vlerë prej 248,543.51€, ndërsa kundër Infrakos në cilësinë e debitorit i kanë arritur 2 propozime për përmbarim në vlerë prej 58,944.24 €.
- Gjatë vitit po ashtu janë mbajtur kontaktet me përmbaruesit privat të angazhuar më lëndët e Infrakos-it dhe në vazhdimësi kërkohet angazhim me i madh në drejtim të ekzekutimit të rasteve. Ngecjet janë kryesisht për shkak te mungesës se te dhënave pasi kemi të bëjmë me lëndë të vjetra.
- Gjatë vitit stafi i zyrës ligjore ka qenë i angazhuar edhe në hartimin e rregulloreve dhe akteve tjera të brendshme të kompanisë si dhe kanë udhëheq punë e komisionit disiplinor dhe të ankesave.
- Në vazhdimësi po punohet në azhurnimin dhe zhvillimin e bazës

se të dhënave për lëndët në gjykata dhe procedurë përmbarimore në mënyrë që menaxhmenti i kompanisë të mund të ketë një pasqyrë të qartë të vlerësimit të rrezikut dhe trendëve nga procedurat ligjore.

*Tabela Tabela 9. Lendet ne procedurë gjyqësore*

| RAPORTI PËRMBLEDHËS I LËNDËVE NË PROCEDURË GJYQËSORE | | |
|---|---|---|
| Numri i përgjithshëm i lëndëve | Infrakos si PADITËS | Infrakos si e PADITUR |
| 388 | 318 | 70 |
| Vlera e përgjithshme financiare | Vlera e financiare | Vlera financiare |
| 6,225,347.47 € | 2,002,193.60 € | 4,223,153.87 € |
| LLOJI I KONTESTIT | | |
| Civile | Penale | Marrëdhënie Pune |
| 332 | 37 | 19 |
| 85.6% | 9.5% | 4.9% |
| Natyra e specifike e kontesteve – nën kategorizimi | Numri i lëndëve sipas nën kategorizimit | Përqindja sipas nën kategorizimit |
| **Q** - Borxhe nga QIRATË | 93 | 23.97% |
| **QLP** - Lirim prone dhe borxh nga qiraja | 20 | 5.15% |
| **KDU** - Kompensime të dëmeve nga Uzurpimet | 60 | 15.46% |
| **PP** - Penale (nga uzurpimet dhe vjedhje) | 34 | 8.76% |
| **LP** - Lirim Prone | 84 | 21.65% |
| **B** - Banesore, ndërtime në pronën e Infrakos | 25 | 6.44% |
| **P** - Konteste lidhur me të drejtën e pronësisë | 19 | 4.90% |
| **MP** - Marrëdhënie pune | 18 | 4.64% |
| **KDA** - Kompensime të Dëmeve nga Aksidentet | 11 | 2.84% |
| **KDP** - Kompensime dëmi që rrjedhin nga veprat penale | 7 | 1.80% |
| **A** - Administrative | 1 | 0.26% |
| **KD** - Kompensim të dëmeve. | 6 | 1.55% |
| **T** - Tjera | 4 | 1.03% |
| **AK** - Anulim Kontrate | 0 | 0.00% |
| **AV** - Anulim Vendimi | 3 | 0.77% |
| **E** - Ekonomike | 2 | 0.52% |
| **MS** - Masë e Sigurisë | 1 | 0.26% |
| STADI I PROCEDURËS | Numri i rasteve | Përqindja % |
| Shkallë e parë | 328 | 84.54% |
| Shkallë e dytë | 57 | 14.69% |
| Shkallë e tretë | 3 | 0.77% |

| PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM TË RREZIKUT | | |
|---|---|---|
| Rezik i Lartë | Rrezik i Mesëm | Rrezik i Ulët |
| 64 | 244 | 78 |
| 16% | 63% | 20% |
| Vlerësimi i rrezikut në vlerë monetare - INFRAKOS si PADITËS | | |
| Rezik i Lartë | Rrezik i mesëm | Rrezik i Ulët |

| | | |
|---|---|---|
| 31 | 219 | 68 |
| 8% | 56% | 18% |
| 1,231,972.87 € | 755,254.56 € | 14,966.17 € |
| Vlerësimit i rrezikut në vlerë monetare – INFRAKOS si I PADITUR | | |
| Rezik i Lartë | Rrezik i Mesëm | Rrezik i Ulët |
| 33 | 25 | 10 |
| 9% | 6% | 3% |
| 4,055,294.96 € | 162,289.12 € | 5,569.79 € |

### 4.9.1 Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it për vitin vijues

Në vitin vijues ndërmarrjen e presin kontestet gjyqësore të natyrës së njëjtë të cilat janë të ndërlidhura me pagesat e borxheve ndaj kompanisë, uzurpimin e pronës, çështjet banesore, dëmet e infrastrukturës, vërtetimin e pronësisë, kompensimet e dëmeve nga aksidentet, marrëdhënia e punës dhe padite për kompensim të shpronësimeve të viteve 1960-ta që paraqesin çështjet me rrezik të lartë. Mund të ketë edhe ndonjë kontest të ri të natyrës tjetër. Zyra Ligjore në kuadër të kapaciteteve profesionale që posedon angazhohet që me përkushtim t'i mbrojë dhe përfaqësoj interesat e kompanisë.

**Sfidë dhe raste me rrezikshmëri të lartë janë disa konteste që ndërlidhen me marrëdhënien e punës dhe aksidente hekurudhore e që në total mund të arrijnë vlerën prej rreth 190,000€, *si dhe disa raste për kompensim nga shpronësimet viteve 1960-të në Komunën e Prizrenit të cilat në total arrin vlerën prej rreth 3.5 milion euro.***

### 4.9.2 Përfundimet/sugjerimet dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2023, stafi i sektorit ligjor ka qenë i angazhuar dhe i përfshirë edhe në punë dhe detyra tjera në Kompani. Aktualisht stafi i sektorit ligjor është duke e përballuar mirë fluksin e punëve të lëndëve në gjykata dhe përmbarim. Me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve brenda kompanisë, po e ritheksojmë se sektori ligjor sugjeron që:

- Menaxhmenti të trajtoj me prioritet paditë për kompensim të pagesave nga shpronësimet e viteve 1960-ta në Komunën e Prizrenit me rastin e ndërtimit te linjës hekurudhore, pasi kanë të bëjnë me vlera shumë të larta financiare dhe paraqesin rrezik të lartë për kompaninë.
- Të respektohet plotësisht legjislacioni primar dhe sekondar për marrëdhënien e punës, në mënyrë që të shmangen pasojat ligjore dhe financiare për ndërmarrjen;
-
- Të bëhet mirëmbajtja adekuate e dosjeve të klientëve në kompani me fatura origjinale dhe dokumentet tjera, menaxhimi i duhur dhe efikas i kontratave të qirave dhe afateve të pagesave për shkak të rrezikut nga parashkrimi dhe mos krijimi i borxheve është e domosdoshme

për efikasitet në procedura ligjore, veçanërisht ato përmbarimore.

- Të përcillet niveli i borxheve nga prona dhe financat në mënyrë qe të shmangen problemet ligjore dhe parashkrimet eventuale dhe të zbatohen në mënyrë rigoroze kontratat dhe rregullorja e pronës.
- Të trajtohen borxhet me komuna duke përfshiu edhe tatimet.
- Të ndërmerren veprime konkrete dhe të vazhdueshme që të evidentohen dhe pengohen në shfrytëzuesit e paautorizuar të pronës, në rast se ka të tilla, në mënyrë që të ndërpritet çfarëdo afati i parashkrimeve fituese dhe të manifestohet vullneti i Infrakos për menaxhimin e pronës.
- Duhet të trajtohet çështja e ndërtimeve në pronën e Infrakos, se si t'i qasemi kësaj problematike.
- Tek qiradhënia të respektohen distancat ligjore ku ka ndërtime eventuale, të trajtohen rastet e borxhlinjve, veçanërisht atyre me shuma të larta dhe të sigurohemi qe të mos tejkalojnë afatin 3 vjeçar pa iniciuar procedura ligjore.
- Të procedohen në zyrën ligjore të gjitha rastet e uzurpimeve dhe borxheve që të iniciohen procedurat ligjore.
- Të trajtohet në manexhment angazhimi i Infrakos në mirëmbajtjen e vendkalimeve hekurudhore, përkatësisht këndeve të shikueshmërisë se tyre dhe largimi i vendkalimeve ilegale.
- Të përfillen plotësisht procedurat ligjore dhe aktet e brendshme të kompanisë në mënyrë që të shmangen kontestet ligjore që krijojnë pozicione të pa favorshme ligjore për kompaninë.

Krahas punëve të rregullta, sektori ligjor në vazhdimësi koordinon veprimet me departamentin e pronës dhe financave për procedimin e lëndëve në procedura ligjore si dhe kompletimin e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm, në ketë drejtim presim që të ketë përmirësime të vazhdueshme.

## 4.10 Sektori për marrëdhënie me publikun & marketing, shkollim & mbrojtje dhe siguri në punë

Sektori i Marrëdhënies me Publikun, Shkollim Mbrojtje në Punë është sektor i ri mbi bazën e strukturës organizative në kompaninë Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A "INFRAKOS" i cili përmban në vete zyrtarin për informim dhe shërbimin për Shkollimi, Mbrojtje në Punë.

Ky sektor mbështetë kompaninë nga fusha të ndryshme profesionale të shërbimeve të lartpërmendur siç është: fusha e informimit dhe marrëdhënia me publikun, shkollimi permanent për

stafin ekzekutiv, ngritja e kapaciteteve e stafit mbrojtja në punë etj.

Sektori ende nuk është i konsoliduar sipas shtrirjes së skemës organizative e cila është në funksion me sistematizim të fundit me 30.11.2022, por ne e paraqesim nevojën tonë për të plotësuar stafin në mënyrë qe ta rrisim efikasitetin në punë dhe për të arritur përmbushjen e objektivave sipas Planit të Biznesit. Pra, edhe përkundër vështirësive ky sektor është duke i zhvilluar aktivitetet e saj në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij sektori dhe kompanisë në tërësi.

**Sektor i MPM-së** - gjatë këtij periudhe ka përmbushur me sukses objektivat e saj, gjithherë duke ndjekur rrugëtimin e përcaktuar me Planin e Veprimit për vitin 2022, duke ndërtuar strategji të pasqyrimit të medieve në përmirësimin e imazhit të kompanisë INFRAKOS.

Ky sektor mban kontakte të vazhdueshme dhe përcjell mediat elektronike në vazhdimësi.

Po ashtu ky sektor kujdeset për nevojat e përkthimeve të vazhdueshme në kompani dhe është duke i kryer të gjitha obligimet në bazë të kapaciteteve qe kemi, si dhe në mënyrë permanente bënë dhe merret me shqyrtimin e kërkesave fillestare për qasje në asetet infrastrukturore.

Po ashtu sektori i MPM në vazhdimësi i ka përcjellë aktivitetet e menaxhmentit dhe të KE-së me qëllim të promovimit të aktiviteteve nëpërmjet rrjeteve sociale dhe web faqes se kompanisë.

**Shërbimi i SHMSP** - ka përmbushur me rregull planifikimet, ka bërë administrimin dhe planifikimin e shkollimit në mënyrë të kënaqshme.

Po ashtu, edhe sa i përket sigurisë në punë kemi një situate relativisht të mirë, natyrisht jemi në përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të punës se stafit dhe vendqëndrimeve të stafit falë investimeve të projektit për rehabilitimin e linjës se dhjetë hekurudhore.

Vlen të theksohet se edhe gjatë këtij viti ky shërbim është marrë me provimet periodike për stafin ekzekutiv dhe me shkollim permanent krahas punëve dhe detyrave të përcaktuara në këtë shërbim.

Sektori i MPM (Marrëdhënia me Publikun dhe Marketing)-

Sektori për Marrëdhënie me Publikun në fushën e marrëdhënieve me media dhe publikun të kësaj kompanie ka arritur që edhe gjatë vitit 2023 të jetë e kërkuar në mbrojtjen e imazhit në pasqyrimin e kompanisë në përgjithësi si dhe shqyrtimin e kërkesave të nevojshme nga palët e interesuara për qasje apo shfrytëzim të aseteve infrastrukturore.

Sektori për marrëdhënie me publikun mban kontakte të vazhdueshme dhe përcjell mediat elektronike në vazhdimësi, hulumton materiale në adresa elektronike qe kanë të bëjnë me INFRAKOS-in.

Po ashtu intensivisht është marrë me publikimet e aktiviteteve të KE-së

dhe aktivitetet në teren sa i përket rehabilitimit të linjës se 10-të hekurudhore.
Po ashtu gjatë vitit 2023 janë kryer punët ditore si në vijim:

- Janë kryer të gjitha punët ditore të Sektorit të MPM-së.
- Janë monitoruar të gjitha adresat dhe portalet elektronike.
- Janë shqyrtuar kërkesat e palëve të treta.
- Gjithashtu është punuar edhe në përmbushjen e punëve dhe detyrave tjera të caktuara.

Gjatë kësaj periudhe janë publikuar në rrjetin social dhe web faqe të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me kompaninë.
Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023 rreth zhvillimeve të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme i kemi bërë rreth 80 publikime në rrjetin social duke i përfshi edhe aktivitetet mediatike të postuara në mediat elektronike dhe ato të shkruara

## 4.10.1 VIZITAT DHE AKTIVITETET KRONOLOGJIKE GJATË VITIT 2023

Përgjatë vizitave për se afërmi me punimet qe janë duke u zhvilluar në evitimin e pengesave të shembjes se tuneleve në segmentin hekurudhor Kaçanik – Elez Han. Fatkeqësia e këtyre shembjeve ka qenë një ndër faktorët qe nuk ka arritur përfundimi i punimeve sipas kontratës qe ka të bëjë me përfundimin e fazës se parë Elez Han – Fushë Kosovë e cila është në kuadër ë rehabilitimit të linjës se 10-të hekurudhore qe kanë bërë të ditur pune kryesi GCF dhe organet mbikëqyrëse të këtij projekti para Kryeshefit Ekzekutiv.

Kryeshefi Ekzekutiv z. Naser Krasniqi posa ka pranuar detyrën se bashku me organet mbikëqyrëse PIU dhe Hill Internationel viziton punishten në tunelin 6 dhe 7 në Elez Han, ku u njoftuan për se afërmi me punimet qe janë duke u zhvilluar në evitimin e pengesave të shembjes se tuneleve në segmentin hekurudhor Kaçanik – Elez Han.



Fatkeqësisht gjendja ishte e pa shpresë dhe tejet e rënduar dhe qe si rezultat nuk ka arritur përfundimi i punimeve sipas kontratës me përfundimin e fazës se parë Elez Han – Fushë Kosovë e cila është në kuadër

ë rehabilitimit të linjës se 10-të hekurudhore.

Kryeshefi Ekzekutiv, zotohet ta ketë prioritet primar përfundimin e rehabilitimit të linjës se 10-të hekurudhore, i cili kërkon angazhim të madh qe të evitohen këto pengesa dhe të bëjnë të mundur qarkullimin e trenave sa më parë. Qe nga ky moment Kryeshefi Ekzekutiv se bashku me punë kryesin dhe organet mbikëqyrëse ka shqyrtuar të gjitha mundësitë qe në rastin e shembjeve të tuneleve të gjejnë mundësi të tejkalimit të kësaj situate në mënyrë qe të bëhet e mundur qarkullimi i transportit hekurudhor deri në rivitalizimin e tuneleve dhe komplet fazën e parë të linjës se 10-të hekurudhore.



Gjendja e Tunelit në mars të vitit 2023



Gjendja e tunelit gjatë progresit

## 4.10.2 VIZITAT E RADHËS NË PRILL, MAJ DHE QERSHOR TË VITIT 2023

Gjatë muajve Prill, Maj, Qershor, kontraktori ka vazhduar me punime në fazën e parë të linjës 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), ku njëherit janë zhvilluar negociata me kontraktorin për vazhdim të punimeve dhe shtyrjen e datës përfundimit duke e marrë parasysh ndërtimin e urave të reja.

Nga këto negociata palët Infrakos dhe GCF (kontraktori) kanë rënë dakord qe bashkërisht ta shtyjnë datën e përfundimit për arritjen e një marrëveshje për një shtojcë me Nr. 5

deri me 31.07.2023 ndërsa gjatë kësaj



periudhe të nënshkruhet Adendumi nr. 4 i Kontratës. Gjatë periudhës Prill – Qershor vlera e punës ka mbërritur: Absorbimi financiar 63.17%, Progresi fizik në linjë është 76% (60.493 km nga 79.57km janë instaluar në linjë). Materialet (Shinat, Traversat, Ndërrueset, Balasti etj.) janë thuajse 99% në vend.



Vonesa ndërmjet progresit financiar dhe atij fizik është për shkak të materialeve të superstrukturës, të cilat përfaqësojnë 48% të kostos totale të projektit.

Realizimi dhe përshpejtimi i punëve në realizimin e projektit mbeten detyrim i të gjitha palëve të angazhuara në këtë projekt që nga Kontraktori, Mbikëqyrësi deri tek INFRAKOS-i.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023 respektivisht në fund të muajit Maj 2023 gjatë një vizite bashkërisht me Bordin e Drejtorëve shihet një dritë në fund të tunelit si rezultat qe ka pasur zhvillime të theksuar në punimet për rehabilitimin e fazës së dytë të linjës së 10-të hekurudhore respektivisht në sanimin e tuneleve, po ashtu ka pasur zhvillime të theksuara edhe në fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë)



Vlen të përmendet se ka vazhduar rehabilitimi i pjesës jugore (fazës së parë) të kësaj linje hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Ashtu siç është cekur më lartë kanë vazhduar negociatat për nënshkrimin e Adendumit nr. 4.



Ka vazhduar rehabilitimi i fazës së dytë Fushë-Kosovë – Mitrovicë,
Janë zhvilluar bisedimet për dizajnin detal dhe dosja e tenderit për projektin Rehabilitimi dhe modernizimi i fazës së tretë të linjës 10-të hekurudhore. Në lidhje me projektin e detajuar ka pasur disa zhvillime, ndryshimi nga IPF9 në IPF11, kjo për shkak të ndryshimeve nga IPF9 në IPF11 data e dorëzimit të projektit pritet të bëhet në TM4 2023, është një parashikim por kjo gjithnjë varet nga situata politike në këtë zonë. Gjatë kësaj periudhe raportuese është dorëzuar Propozimi për Metodologji në Bankën EBRD, ku në të njëjtën janë marrë komente nga Banka rreth çështjeve mjedisore. Këto komente janë duke u rishikuar nga IPF 11 për aprovim nga Banka.

## 4.10.3 INAUGURIMI I TUNELEVE 6 DHE 7

Me datë 04.11.2023 përurohet hapja e tunelit 6 me gjatësi 262m dhe tunelit 7 me gjatësi 122m të cilët ishin plotësisht të shembur si dhe ri-hapja e linjës Hani i Elezit – Fushë Kosovë si segment i parë i linjës 10-të hekurudhore Hani i Elezit.



Në këtë ceremoni, pjesëmarrës ishin Kryeministri i Republikës se Kosovës z. Albin Kurtin, Ministren e Ekonomisë znj. Artane Rizvanolli, Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati, Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu.



Zotimet lidhur me realizimin e këtij projekti u jetësuan i cili projekt lidh dy vendet fqinje nga lindja në perëndim. Praktikisht çdo projekt i madhe, natyrisht se ka sfida të mëdha, por angazhimet për të tejkaluar këtë situatë të rënduar nuk janë ndalur asnjë moment të vetëm deri në realizimin e këtij projekti të vështirë dhe tejet kompleks.




Ky projekt është realizuar falë përkrahjes se Republikës së Kosovës

dhe përfaqësuesve të Zyrës së Bashkimit Evropian, përfaqësues të Fondit për Investime për Ballkanin Perëndimor (WBIF), përfaqësues të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), si dhe Bankës Europiane për Investime (EIB).




Rol të rëndësishëm në këtë projekt kanë edhe përfaqësuesit e WBIF, EIB dhe EBRD të cilët jo vetëm që po na mbështesin financiarisht në këtë projekt, por në vazhdimësi ofrojnë edhe mbështetje konsulente për implementimin e projektit në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian, trajnime të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve njerëzore etj.

Vlen të theksohet se këtu treni dikur mund të zhvillonte shpejtësi jo më shumë se sa 60 kilometra në orë, ndera pas rehabilitimit dhe pranimit teknik treni mund të qarkulloj me shpejtësi mbi 100 kilometra në orë.

### 4.10.4 Infrakos në aksionet humanitare

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh. A "Infrakos". organizon në vazhdimësi aksionin e dhurimit vullnetar të gjakut në bashkëpunim me Ekipën mjekësore nga Transfuzioni i gjakut.



## 4.11 SHËRBIMI PËR SHKOLLIM, SIGURI DHE MBROJTJE NË PUNË

Menaxhimi i rregullt dhe përmbushja e objektivave nga Shërbimi i Shkollimit-Trajnimit, Mbrojtjes dhe sigurisë

Gjatë kësaj periudhe është përcjell plani i veprimit për vitin 2023 si dhe janë përmbushur të gjitha detyrat konformë akteve të brendshme të kompanisë.

Më poshtë i keni disa aktivitete të proceduara gjatë kësaj periudhe nga ky sektor:

- Gjatë kësaj periudhe janë përcjell kontrollimet mjekësore për punëtoret qe hyn në kategorinë me rrezikshmëri, Stafi ekzekutiv (Departamenti i Komunikacionit,

MHL-ës dhe departamenti i Elektroteknikës) .
- Janë bërë inspektimet e nevojshme me kapacitetet qe i posedojmë.
- Mbikëqyren dhe servisimin e aparateve kundër zjarrit në të gjitha objektet qe posedon Infrakos Sh.A
- Janë duke u mbajtur shkollimet permanente për stafin ekzekutiv të Infrakos Sh.A

### 4.11.1 Shkollimi i Rregullt për stafin Ekzekutiv të Infrakos-it

Proceset e punës në Kompani dhe specifikat e saj ndonjëherë e mundësojnë shfrytëzimin optimal të stafit ekzistues por që shtron nevojën që herë pas here të rishqyrtohen, analizohen dhe definohen me qëllim të shfrytëzimit maksimal të ngritjes së kapaciteteve ekzistuese.




Shërbimi për Shkollim/Trajnim, Mbrojtje dhe Siguri ka përgatitur planin për përgatitjen-Shkollimin e stafit ekzekutiv të Infrakos-it në bazë të planit dhe udhëzimit për shkollim.

Shkollimi permanent ka filluar duke u bazuar në rregulloret dhe aktet e brendshme të Kompanisë.

Mbajtja e shkollimit të rregullt të stafit ekzekutiv mbahet nga vet departamentet përkatëse pasi që shërbimi i SHMSP-së ende nuk është konsoliduar me kuadrot sipas sistematizimit.

Vlen të theksohet se gjatë 3 mujorit të dytë të vitit 2023 janë mbajtur provimet periodike për gjithë stafin ekzekutiv.

### 4.11.2 Trajnimet për e Stafit të Kompanisë Infrakos Sh.a

Gjatë vitit 2023 nuk kemi pasur kërkesa të aprovuara në lidhje me ngritjet e kapaciteteve.

Po ashtu mundësitë buxhetore nuk janë të mjaftueshme për të realizuar këtë aktivitet, edhe pse ne kemi planifikuar buxhet por që ne mungesë të mjeteve financiare jemi detyruar qe t'i reduktojmë organizimet për ngritje të kapaciteteve bazuar në rekomandimet e dhëna paraprakisht.

Ndërsa ky aktivitet i ngritjes se kapaciteteve presim qe gjatë vitit 2024 të zhvillohet pasi qe në këtë vit kemi planifikuar buxhet të mjaftueshëm.

### 4.11.3 Organizimi dhe mbikëqyrja e kontrollimeve të rregullta mjekësore të punëtorëve

Shërbimi për Shkollim-Trajnim, Mbrojtje dhe Siguri në punë në vazhdimësi përcjell gjendjen psiko – fizike të punëtorëve.

Këtë bëjmë përmes kontrollimeve të rregullta-sistematik mjekësor të tyre, në bazë të kushteve dhe kritereve të parapara në Rregulloren mbi aftësinë psiko-fizike të punëtorëve të cilët janë staf në Sektorin e Komunikacionit, Sektorin e Sinjalizimit, shërbimin i Energjetikes dhe Shërbimi CTC .

Kontrollimet e rregullta mjekësore-sistematike janë të vazhdueshme dhe janë zhvilluar në bazë të rregulloreve dhe akteve normative të kompanisë.

### 4.11.4 Mbrojtja e shëndetit, ambientit dhe siguria në punë

Shërbimi përkatës në vazhdimësi bënë inspektime të rregullta dhe kemi konstatuar se NP Infrakos ka nevojë për investimeve nga aspekti i mbrojtjes së shëndetit dhe i sigurisë në punë.

Vlen të theksohet se vlerësimi i riskut duhet të rishikohet çdo dy vite nga udhëheqësit e veprimtarive ekzekutive nëse do të ketë nevojë për ndonjë ndryshim eventual.

Po ashtu, vlen të përmendet se qe nga viti 2022 nuk jemi furnizuar me rroba mbrojtëse dhe uniforma në asnjërën sezon duke shpresuar qe këtë projekt ta fillojmë me buxhetin e projekteve kapitale, mirëpo gjatë këtij viti do të vazhdojmë inicimin e këtij projekti nga buxheti operativ.

### 4.11.5 Mbikëqyrja dhe inspektimi

Siç u potencua edhe në pikën 5 lidhur me mbikëqyrjen dhe inspektimin e vendeve të punës dhe ndërmarrjen e masave lidhur me sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve sektori për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë ka bërë identifikimin e nevojave për përmirësimin e këtyre kushteve në shumë stacione hekurudhore, mirëpo pasi qe jemi në zhvillimet e projekteve shpresojmë qe kushtet dhe vendqëndrimet e stafit do të përmirësohen edhe me tej nga ana e kontraktorit.

### 4.11.6 Mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore

Sipas legjislacionit në fuçi e kemi përcjellë skadimin për servisimi të aparateve kundër zjarrit e cila e rrit sigurinë në aspektin e mbrojtjes kundër zjarrit.

Vlen të theksohet se ky aktivitet sipas legjislacionit në fuqi zhvillohet çdo 6 muaj dhe dy herë në vit bëhet servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit.




## 4.12 Kontrollori i brendshëm

Viti 2023 për kontrollorin e brendshëm ka qenë vit i angazhimeve të mëdha në kontrollimin e infrastrukturës hekurudhore ku përfshihen tri veprimtaritë kryesore të Infrastrukturës hekurudhore, duke përfshi komunikacionin, mirëmbajtjen e linjave hekurudhore dhe veprimtarinë elektroteknike.

### 4.12.1 FUSHA E KONTROLLIT TË BRENDSHEM DHE PLANI I VEPRIMIT

Për të gjithë ne në INFRAKOS, prioritet primarë dhe kryesorë është siguria në komunikacionin hekurudhorë dhe siguria në përgjithësi, në punë dhe shërbime të cilat i ofrojmë. Angazhimi ynë permanent mbështetet në vendosjen dhe ngritjen e një kulture e cila përmban sigurinë, dhe cilësinë si prioritet fondamentalë.

Gjatë kontrollit në zbatimin e rregulloreve gjatë vitit 2023 , kujdes i veçantë i është kushtuar personave nga të cilët varet siguria në transportin hekurudhor, duke filluar nga faktori njeri, intensiteti dhe organizimi i transportit, gjendjes së kapaciteteve teknologjike dhe mirëmbajtjes së tyre.

Me rastin e realizimit të kontrollit gjatë tërë vitit 2023 është kërkuar qe të respektohen rregulloret në fuqi, nga se janë me rëndësi të veçantë për vendet e caktuara të punës. Po ashtu gjatë kontrollit janë dhënë vërejtje dhe është bërë pasqyrimi i lëshimeve të bëra të shoqëruar me komente mbi pasojat në rast se nuk respektohet edhe më tutje zbatimi i rregulloreve përkatëse.

Kontrolli i brendshëm i sigurisë është bërë në përputhje me planin vjetor 2023 të mbikëqyrjes dhe kontrolli i shprehur në vijim.

Komunikacioni hekurudhor është sistem i veçantë dhe me specifikat e veta kërkon nivel të lartë të sigurisë dhe përgjegjësi maksimale. Për Arritjen e nivelit të sigurisë dhe mbarëvajtjen e komunikacionit hekurudhor në periudhën e vitit të kaluar janë punuar shumë punë por kanë mbet pa u kryer edhe disa punë qe jemi brenda afateve kohore.

### 4.12.2 Inspektimet e personelit

Personeli në shërbimin ekzekutiv ka përgatitjen e duhur profesional, mirëpo për shkak të moshës dhe pensionimit të tyre kërkon marrjen e masave të nevojshme për përtëritjen edhe me tutje me kuadro të reja profesionale në të gjitha nivelet e përgatitjes profesionale.

Kontrollimet shëndetësore kryhen me rregull dhe të gjithë e kanë grupin e kërkuar shëndetësor për vendin e punës ku punon, duke marr parasysh moshën e tyre supozoi se kontrollimet shëndetësore në institutin e mjekësisë të punës kryhen në bazë të kritereve të parashikuara me rregulloren e shëndetësisë të HK-ës.

Në vendet e punës të shërbimit ekzekutiv mungojnë Rregulloret e domosdoshme në gjuhën shqipe, për veç Rregullores së sinjalizimit të komunikacionit udhëzimi mbi manovrimin, rregullore tjera nuk ka në stacione.

Shkollimi i rregullt i punonjësve nëpër vendet e shërbimit, është mbajtur në bazë te plan programit të instruktorit shkollor i përpiluar nga rregullorja 646 dhe rregulloren e punës në mënyrë që të kenë përgatitjen për përgjegjësit që i kërkon komunikacioni hekurudhorë, mirëpo pas shkuarjes në pension të instruktorit shkollor shkollimin e kanë vazhduar ta mbajnë shefat e stacioneve hekurudhore, gjë qe kërkohet të plotësohet pozicioni me instruktor te shkollimit.

Zbatimi i rregullave dhe udhëzimeve për mënyrën e organizimit dhe rregullimit të komunikacionit hekurudhor në rrjetin hekurudhor të HK-ës, është në nivel të kënaqshëm fal përvojës dhe përgjegjësisë së punonjësve në shërbim, dhe fal punës në fushën e kontrollit duke ju dhënë vërejtje dhe sugjerime në çdo kohë.

### 4.12.3 Gjendja e Objekteve

Gjendja e objekteve në shërbim të komunikacionit (ndërtesat e stacioneve, punëtorit dhe ndërtesat të roleve), edhe se janë bërë disa punime para disa viteve në shumë vende kërkohet investim qe të krijohen kushtet normale për punë, por me rehabilitimin e linjave do të bëhet dhe rregullimi i objekteve që i shërbejnë komunikacionit.



Për shkak të manovrimit të pandërprerë dhe përdorimit me çelësat e ndërrueseve të siguruara me brava

në stacionin e Drenasit , është rregulluar shtëpiza tek blloku 1. Ka 8 vite që është bërë ndërtimi dhe nuk është vër ne funksion, mos funksionimi po bën që te degradohet – shkatërrohet ajo B- Shtëpizë, kërkohet të rregullohet shtëpiza dhe ne bllokun 2 në mënyrë që ndërruesi në shërbim të qëndroj aty gjatë sigurimit të rrugës së kalimit të trenit më lehtë të përdori me çelësat ku dhe do te jetë siguria më e madhe, në stacionin e Drenasit duke marrë parasysh që zhvillohet komunikacion dhe natën në ketë stacion dhe ndriçimi në hapësirat e rajonit të ndërrueseve kërkon një qasje për arsye qe nuk ka ndriçim fare e jo vetëm në stacionin Drenas por ka dhe stacione të tjera që mungon ndriçimi i duhur tek ndërrueset



### 4.12.4 Gjendja e Infrastrukturës

Gjendja e infrastrukturës hekurudhore në linjat aktive është mesatarisht e kënaqshme, pasi që angazhimi i pa ndërprerë i sektorit të mirëmbajtjes së linjave e ka bërë qe qarkullimi i mjeteve në hekurudhë të jetë i sigurte dhe të operoj pa ndonjë problem.

### 4.12.5 Linja hekurudhore Mitrovicë – Fushë Kosovë – Hani i Elezit

Kjo linjë hekurudhore në përgjithësi për shkak të punimeve po thuaj se në tërë vitin ka qënë e mbyllur dhe nuk është zhvilluar komunikacioni sipas Orarit të Lëvizjes së Trenave për vitin 2022/2023. Vlen të ceket se për shkak të punimeve të kësaj linje vazhdon mbyllja për komunikacionin hekurudhor segmenti Fushë Kosovë – H. Elezit. Vazhdojnë punimet për rehabilitimin e linjës 10, dhe kjo Linjë vazhdon e mbyllur për komunikacion për nevoja të punë kryerësit – projektit dhe sipas marrëveshjes ku trena të rregullt nuk ka, e nëse paraqitet nevoja për lëvizje të ndonjë treni fakultativ duhet të organizohet lëvizja e tyre pas hapjes së linjës.





### 4.12.6 Vend Kalimet hekurudhore:

Përveç v. kalimeve të cilat ndërtohen si pas tekeve . Deri më sot nuk është vepruar si pas rekomandimeve të GP që nga viti 2009, për eliminimin e numrit të caktuar të v. kalimeve ilegale hekurudhor në nivel, ku duhet pa tjetër të intervenohet gjë qe numri i madh i vend kalimeve ne nivel po vështirëson komunikacionin hekurudhorë ku dhe po rrezikon në masë te madhe sigurinë e komunikacionit .

### 4.12.7 Parashenjat shenjëdhënësit dhe shenjave treguese

Gjendja e parashenjave, shenjëdhënësve dhe shenjave treguese:

Parashenjat, shenjëdhënësit dhe shenjat treguese në linjat hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë janë jashtë funksionit. Shtyllat mbajtëse dhe koshi për dhënien e shenjave sinjalizuese janë të demoluar, të koroduar dhe nuk i shërbejnë qëllimit;

Shtyllat për tregimin e kilometrit edhe pse është kërkuar disa herë të vendosën, janë vendosur një numër i mirë por një numër i konsiderueshëm i tyre është në – mungesë.

Shenjat treguese në stacione dhe në tërë rrjetin hekurudhor të HK-ës, në masën më të madhe janë të dëmtuara rënd (janë deformuar), në shumë vende nuk ekzistojnë fare, ato ekzistuese janë të ekspozuara korrozionit ( ndryshkut) plotësisht, vetë gjendja e tyre në as një mënyrë nuk i shërben qëllimit.











# 5 Pasqyrate performancës financiare

## 5.1 Përformanca financiare e INFRAKOS-it

Ngjashëm me vitin paraprak gjendja financiare e INFRAKOS-it në vitin 2023 ka qenë tepër e vështirë dhe angazhimi i jonë gjatë tërë vitit ka qenë i fokusuar në mbikëqyrjen e të hyrave dhe shpenzimeve, ashtu që kompania të mund të funksionojë në kushte ta quajmë të jashtëzakonshme. Rënia e të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet për shkak të rënies së transportit të mallrave (për çka përgjegjës është TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i), po ashtu ndërprerja e qarkullimit të trenave në linjën Fushë-Kosovë – Hani i Elezit për shkak të punimeve në rehabilitimin e këtij segmenti hekurudhore, si dhe mungesa e subvencionimit të kërkuar nga qeveria na ka sjellë në një situatë tejet të vështirë financiare me çka gjatë tërë vitit ka qenë i rrezikuar funksionimi i kompanisë.

Është e ditur se të hyrat kryesore të INFRAKOS-it (pagesat e qasjes në rrjet dhe subvencionimi) nuk varen nga ne, andaj kjo ka paraqitur një sfidë tepër të madhe. Ne në mënyrë të vazhduar kemi shprehur shqetësimin tonë tek institucionet përgjegjëse për mosplotësimin e obligimeve ligjore ndaj INFRAKOS-it, por për fat të mirë kërkesat tona ndaj këtyre institucioneve gjatë vitit 2023 kanë rezultuar me nënshkrimin e marrëveshjes pesëvjeçarë dhe po ashtu edhe me marrjen e subvencionit ne muajin dhjetor 2023. Ne gjatë vitit 2024 shpresojmë që më në fund institucionet përgjegjëse t'i kryejnë obligimet e tyre ligjore karshi INFRAKOS-it.

Në tabelën vijuese janë paraqitur në mënyrë të detajuara të gjitha llojet e të hyrave dhe shpenzimeve të INFRAKOS-it gjatë vitit 2023, duke i krahasuar ato me buxhetin e planifikuar të vitit 2023, si dhe duke i krahasuar ato me të hyrat dhe shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2022.

Tabela1.Paraqitja totale te te gjitha te hyrave dhe shpenzimeve.

| | Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve | Realizimi 2022 | Realizimi 2023 | Buxheti 2023 | Diferenca | Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | A | B | C | B - A | B - C |
| TË HYRAT | Te hyrat nga TM | 17,683.00 | 25,052.00 | 13,080.00 | 7,369.00 | 11,972.00 |
| | Te hyrat nga TU | 177,938.00 | 184,915.00 | 173,997.00 | 6,977.00 | 10,918.00 |
| | Të Hyrat nga Qiraja | 907,349.00 | 958,928.00 | 830,687.00 | 51,579.00 | 128,241.00 |
| | Të Hyrat Tjera | 127,715.00 | 171,653.00 | 149,470.00 | 43,939.00 | 22,183.00 |
| | Te hyrat e shtyra nga gra.-BK | 907,425.00 | 984,927.00 | 876,858.00 | 77,502.00 | 108,069.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sub. për oblig.nga marrve. me Qeverin | 799,481.00 | 845,674.00 | 800,000.00 | 46,193.00 | 45,674.00 |
| | 38100 - Sub. për dif.e tarifave nga ER | - | - | 2,563,860.00 | - | -2,563,860.00 |
| | **Të hyrat totale** | 2,937,591.00 | 3,171,149.00 | 5,407,952.00 | 233,558.00 | -2,236,803.00 |
| SHPENZIMET | Pajisjet | 1,246.00 | 825.00 | 31,530.00 | -421.00 | -30,705.00 |
| | Harxh. e lokal. ndërtesave | 49,592.00 | 15,681.00 | 61,067.00 | -33,911.00 | -45,386.00 |
| | Energjia elektrike | 82,065.00 | 95,282.00 | 130,686.00 | 13,217.00 | -35,405.00 |
| | Nafta | 29,464.00 | 25,851.00 | 34,106.00 | -3,614.00 | -8,255.00 |
| | Vajrat, lyerësit, etj. | 629.00 | 2,099.00 | 4,719.00 | 1,470.00 | -2,260.00 |
| | Materiali harxhues operativ | 8,935.00 | 32,155.00 | 15,174.00 | 23,220.00 | 16,981.00 |
| | Riparimet | 10,270.00 | 10,877.00 | 31,805.00 | 607.00 | -20,928.00 |
| | Shërbimet operative | 34,076.00 | 2,176.00 | 5,176.00 | -31,900.00 | -3,000.00 |
| | Udhëtimet zyrtare | 1,243.00 | 6,103.00 | 17,268.00 | 4,860.00 | -11,165.00 |
| | Marketingu dhe publikimet | 3,398.00 | 42,754.00 | 14,725.00 | 39,356.00 | 28,029.00 |
| | Mat. i zyrës dhe konsumues | 38,790.00 | 13,297.00 | 22,712.00 | -25,493.00 | -9,416.00 |
| | Telefoni / mail / interneti | 9,658.00 | 9,250.00 | 11,941.00 | -407.00 | -2,691.00 |
| | Shpenz. e rrezikshmërisë | 11,034.00 | 30,317.00 | 230,564.00 | 19,283.00 | -200,247.00 |
| | Reprezentacioni konsumueset | 4,212.00 | 7,558.00 | 7,916.00 | 3,347.00 | -358.00 |
| | Sigurimi | 9,410.00 | 41,331.00 | 39,754.00 | 31,921.00 | 1,577.00 |
| | Stafi i jashtëm | 1,420.00 | 987.00 | 7,290.00 | -434.00 | -6,303.00 |
| | Stafi dhe punëtorët | 1,803,252.00 | 1,710,139.00 | 2,030,737.00 | -93,113.00 | -320,598.00 |
| | Shpenzimet tjera operative | 5,412.00 | 49,860.00 | 520,037.00 | 44,448.00 | -470,177.00 |
| | Gjithsejtë shpenzimet op | 2,104,108.00 | 2,096,542.00 | 3,217,209.00 | -7,565.00 | -1,120,667.00 |
| 1.Diferenca (të hyrat - shpenzimet) rez. operativ | | **833,483.00** | **1,074,606.00** | **2,190,743.00** | **241,123.00** | **-1,116,137.00** |
| 2.Amortizimi | | 1,057,416.00 | 1,060,796.00 | 1,068,322.00 | 3,379.00 | -7,526.00 |
| 3.Shpenzimet e provizionimit | | 0.00 | 549,230.00 | 0.00 | 549,230.00 | 549,230.00 |
| 3.Shpenzimet tjera financiare | | 57,871.00 | 149,380.00 | 4,545.00 | 91,509.00 | 144,835.00 |
| Rezultati neto=1-2-3 | | **-281,804.00** | **-684,800.00** | **1,117,876.00** | **402,996.00** | **-1,802,676.00** |

### 5.1.1 Të hyrat e planifikuara dhe ato të realizuara

Në drejtim të qartësimit të nevojshëm në vazhdim është bërë përshkrimi i të hyrave dhe shpenzimeve të prezantuara në tabelën e mësipërme

**Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit TM–** Këto të hyra (si të hyrat kryesore të INFRAKOS-it) krijohen nga pagesat e qasjes në rrjet të cilat i ka bërë TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i në emër të shfrytëzimit të rrjetit dhe sipas Ekspozeut të Rrjetit 2023. Siç shihet nga tabela e mësipërme, në vitin 2023 janë realizuar 25,052.00€ apo 92 % më të larta sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 13,080.00 €. Krahasuar me vitin 2022, kur kishim realizuar 17,683.00€, të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit janë për 7,369.00€ më shumë apo 42 % rritje.

**Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit TU–** Këto të hyra (si të hyrat kryesore të INFRAKOS-it) krijohen nga

pagesat e qasjes në rrjet të cilat i ka bërë TRAINKOS-i në emër të shfrytëzimit të rrjetit dhe sipas Ekspozeut të Rrjetit 2023. Siç shihet nga tabela e mësipërme, në vitin 2023 janë realizuar 184,915.00€ më të shumë apo 6 %rritje sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 173.997.00 €.

Krahasuar me vitin 2022, kur kishim realizuar 177,938.00€, të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit janë për 6,977.00€ më shumë apo 4 %rritje.

Të hyrat nga qiraja – Burimi i dytë i të hyrave të INFRAKOS-it padyshim se janë të hyrat nga qiraja. Gjatë vitit 2023 janë realizuar 958,928.00€ apo 15 % më shumë nga shuma e planifikuar për këtë vit e cila kapë vlerën prej 830,687.00 €. Pra, shihet se kemi një rritje të këtyre të hyrave në vlerën prej 128,241.00 € në krahasim me buxhetin e planifikuar. Krahasuar me vitin 2022 kur kishim realizuar 907,349.00 €, në vitin 2023 të hyrat nga qiraja janë për 51,579.00 € më shumë apo 6 % rritje.

**Të hyrat tjera** – Vlen të ceket se realizimi i të hyrave tjera është bërë nga mirëmbajtja dhe riparimet e binarëve privat industrial, ofrimi i shërbimeve në terminalin e mallrave për të gjithë klientët të cilët e kanë shfrytëzuar atë terminal për ngarkim shkarkimin e mallrave, pastaj ofrimi i shërbimeve tjera dhe shitja e skrapit të dalë jashtë përdorimit.

Prandaj sa i përket të hyrave të tjera, në vitin 2023 janë realizuar 171,653.00€, apo 15% më të larta sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 149,470.00 €. Krahasuar me vitin 2022 kur kishim realizuar 127,715.00€,në vitin 2023 të hyrat tjera janë për 43,939.00€ më të larta apo 34 % rritje.

**Subvencionimi nga qeveria** – Nga viti 2012 kemi kërkuar nga Qeveria, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës si dhe ajo e Ekonomisë që të bëjnë subvencionimin e ndryshimit të tarifave nga pagesat e qasjes në rrjet, tarifa këto të cilat INFRAKOS-i i ka përpiluar në bazë të kostos direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës, ndërsa MMPHI-ja i ka zbritur çdo vit në mënyrë drastike. Për fat të keq asnjëherë deri më sot nuk kemi hasur në mirëkuptim nga institucionet përkatëse që të mbulojnë tërësisht diferencat e kërkuara. Pra, edhe në vitin 2023 ka vazhduar e njëjta praktikë e viteve paraprake ku qeveria, respektivisht ministritë përgjegjëse nuk e kanë kryer obligimin për mbulimin e diferencës së pagesave nga qasja në rrjet tërësisht.

Mosgatishmëria e institucioneve përgjegjëse për subvencionimin e plotë të shumës së paraparë, ka ndikuar që ne të bëjmë reduktime të mëdha në shpenzimet e planifikuara gjë që nuk është aspak e mirë sepse pasojat në të ardhmen munden me qenë të mëdha, duke e cenuar kështu sigurinë e komunikacionit hekurudhor.

Për këtë arsye Infrakos ka përgatitur Draft Marrëveshjen Financiare Pesëvjeçare (2023 – 2027) dhe ka kërkuar të bëhet nënshkrimi i saj, ashtu që të mos cenohet funksionimi i transportit hekurudhor.

Kërkesa jonë është shqyrtuar dhe fatmirësisht kjo marrëveshje me date 11 dhjetor 2023 është nënshkruar në mes palëve Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe

Infrastrukturës, Ministria e Ekonomisë dhe Infrakos Sh. A., të cilat ministri kanë përmbushur obligimin sipas Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063.

## 5.2 Shpenzimet e INFRAKOS-it

Sa i përket shpenzimeve mund të konstatojmë se shpenzimet operative të realizuara të INFRAKOS-it në vitin 2023 janë 2,096,542.00 €, që në krahasim me shpenzimet e planifikuara 3,217,209.00 €, janë për 1,120,667.00 € apo 35 % më të ulta. Kjo tregon kujdesin e madh të cilin ne e kemi pasur vazhdimisht gjatë realizimit të shpenzimeve duke bërë kursime maksimale, pasi që e kemi analizuar shumë mirë se nuk do të realizohen të hyrat e planifikuara për arsyet e përmendura më lartë.

INFRAKOS-i gjatë tërë vitit ka bërë me shumë kujdes menaxhimin e shpenzimeve duke kursyer maksimalisht në mënyrë që të mund të bëhet funksionimi i kompanisë, kjo ka rezultuar edhe me vështirësi dhe mungesa të caktuara në furnizime me material dhe pjesë rezervë, mirëpo falë kësaj ne kemi arritur të mbijetojmë dhe ta ruajmë sigurinë e duhur të transportit hekurudhor.

## 5.3 Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Më lartë është bërë përshkrimi i të hyrave të INFRAKOS-it në krahasim me buxhetin e vitit 2023, si dhe krahasimi i shpenzimeve të realizuara në krahasim me vitin 2022. Vlen të theksohet se INFRAKOS-i është e vetmja kompani publike të hyrat kryesore të cilës kompani nuk varen nga vetë kompania. Pa marrë parasysh angazhimin maksimal të cilin e ka bërë dhe mund ta bëjë menaxhmenti dhe i gjithë stafi tjetër ndikimi në këto të hyra është tejet minor sepse të hyrat kryesore të INFRAKOS-it varen nga operatorët e transportit hekurudhor.

Në mënyrë që të kemi një sqarim më të detajuar rreth të hyrave dhe shpenzimeve, në tabelën vijuese është bërë paraqitja e të hyrave dhe shpenzimeve totale për vitin 2022 dhe 2023. Në këtë tabelë është bërë prezantimi i të hyrave dhe shpenzimeve reale pa i marrë parasysh të hyrat e shtyra, amortizimin dhe shpenzimet financiare.

Tabela 2.Paraqitja e te gjitha te hyrave dhe shpenzimeve reale.

| Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve | Realizimi 2022 A | Realizimi 2023 B | Buxheti 2023 C | Diferenca B - A | Diferenca B - C |
|---|---|---|---|---|---|
| Të hyrat totale | 2,030,165.00 | 2,186,222.00 | 4,531,094.00 | 156,057.00 | -2,344,872.00 |
| Shpenzimet totale | 2,104,108.00 | 2,096,542.00 | 3,217,209.00 | -7,566.00 | -1,120,667.00 |
| **Diferenca** | **-73,943.00** | **89,680.00** | **1,313,885.00** | **163,623.00** | **-1,224,205.00** |

Bazuar në tabelën 1. e mësipërme shihet se të hyrat e realizuara në vitin 2023 janë 3,171,149.00 €, që krahasuar me të hyrat e planifikuara 5,407,952.00 €, janë për 2,236,803.00 € apo 41 % më

të ulëta sesa planifikimi. Krahasuar me vitin 2022 ku kishim realizuar të hyra në vlerën prej 2,937,591.00 €, në vitin 2023 kemi realizuar 233,558.00 € apo shprehur në përqindje 8 %rritje.

Nga tabela shihet se shpenzimet e operative në vitin 2023 janë 2,096,542.00 €, që krahasuar me shpenzimet e planifikuara 3,217,209.00 €, del se kemi shpenzuar 1,120,667.00 € apo 35 % më ulta sesa ka qenë e planifikuar. Kjo diferencë ka ardhur për shkak se ne kemi kursyer gjatë tërë vitit në mënyrë që INFRAKOS-i të mund të operojë pa problem. Pra, është thënë sa e sa herë që ne kemi kursyer maksimalisht për hir të ruajtjes së stabilitetit financiar të kompanisë.

Diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara në vitin 2023 është -684,800.00€. Këtë vit kemi bërë edhe provizionimin e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 549,230.00 € (provizionimi i llogarive të arkëtueshme nuk është bërë që nga viti 2021)

Bazuar në këtë që u tha më lartë, mund të konstatojmë se viti 2023 ka qenë vit shumë sfidues, por që falë angazhimit të të gjithëve është arritur që të tejkalohet me sukses.

# 6 Progresi sipas planit të biznesit

## 6.1 Pasqyrat e progresit në zbatimin e planit të biznesit

Sikurse në vitet paraprake edhe këtë vit objektivi kryesor i INFRAKOS-it ka qenë që të bënë realizimin e tërësishëm të Planit të Biznesit për vitin 2023. Ky plan ka qenë një plan shumë i mirë, i qartë dhe me mundësi të matjes së përhershme të rezultateve të arritura. Si çdo vit tjetër, edhe këtë vit departamentet dhe sektorët e kompanisë kanë përpiluar planet e tyre të veprimit duke u bazuar në planin e biznesit, ndërsa në bazë të këtyre planeve është përpiluar plani i veprimit i INFRAKOS-it i cili ka qenë udhërrëfyes për të gjitha departamentet dhe njësitë e kësaj kompanie.

Bazuar në rezultatet e arritura, është konstatuar se Plani i Biznesit 2023 (me përjashtim të realizimit e të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet të cilat varen nga TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i, subvencionimit nga shteti i cili nuk është realizuar sipas kërkesave tona) është realizuar pothuajse tërësisht. Sa i përket të hyrave nga patundshmëria dhe të hyrat tjera, të hyra këto që varen nga ne, këtu vërehet një sukses relativisht i mirë i cili pritet të ketë përmirësim në të ardhmen.

## 6.2 Progresi i objektivave kryesore strategjike

Sikurse vitin e kaluar, edhe në vitin 2023 realizimi i objektivave të parapara me planin e biznesit ka qenë njëri ndër prioritetet kryesore të

INFRAKOS-it. Plani i biznesit i vitit 2023 nuk ka pasur ndryshime të theksueshme nga ai i vitit 2022.

- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin më të lartë të mundshëm konform rregullativave dhe legjislacionit në fuqi.
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit.
- Angazhimi maksimal në menaxhimin e mirë të resurseve ekzistuese për realizimin e të hyrave të parapara.
- Ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor në mënyrë korrekte, transparente dhe jodiskriminuese.
- Menaxhimi i mirëfilltë i patundshmërisë si resursi i dytë i krijimit te të hyrave dhe eliminimi i borxheve të këqija
- Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së parë të

Prandaj, ndër objektivat kryesore të ndërlidhura me pasqyrat e progresit janë këto:

Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit).

- Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së dytë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë).
- Fillimi i rehabilitimit të pajisjeve sinjalo siguruese dhe të energjetikës për fazën e parë dhe të dytë (Mitrovicë – Hani i Elezit).
- Vazhdimi i Projekt dizajnit detaj teknik për fazën e tretë (Mitrovicë – Leshak)
- Rihapja e pjesës veriore të Linjës së 10 hekurudhore nga Mitrovica në kufirin me Serbinë.
- Ngritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë.

Në vijim është prezantuar realizimi, apo mosrealizimi i objektivave të mësipërme të cilat paraqesin bazën kryesore të punëve të INFRAKOS-it gjatë vitit 2023:

**Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin më të lartë të mundshëm konform rregullativave dhe legjislacionit në fuqi** – Viti 2023 ka qenë vit i angazhimeve maksimale i sektoreve ekzekutive për ruajtjen e sigurisë në linjat tona hekurudhore. Për këtë arsye, angazhimet e sektorit të MLH-së kanë qenë kontinuale duke mirëmbajtur linjat hekurudhore në nivelin e kërkuar. Ngjashëm ka bërë edhe sektori i VET-së duke i evituar të gjitha pengesat në pajisjet sinjalo – siguruese, telekomunikacionit dhe ato të energjetikës, ndërsa sektori i Komunikacionit ka zbatuar me përpikëri orarin e lëvizjes së trenave. Me një fjalë, është bërë punë e madhe duke e ngritur kështu nivelin e sigurisë për qarkullimin e të gjitha llojeve të mjeteve lëvizëse.

**Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit**
Njëri ndër prioritetet tona edhe në vitin 2023 ka qenë ngritja e kapaciteteve njerëzore të kompanisë. Në mënyrë që të mund ta realizojmë vizionin tonë dhe objektivat e parapara me planin e biznesit, njëra nga detyrat kryesore ka qenë dhe akoma mbetet ngritja e kapaciteteve njerëzore.

**Angazhimi maksimal në menaxhimin e mirë të resurseve ekzistuese për realizimin e të hyrave të parapara** – Njëri ndër prioritetet tona edhe në vitin 2023 ka qenë angazhimi i të gjitha resurseve ekzistuese në drejtim të realizimit e të hyrave të parapara. Ne sot mund të konstatojmë se të hyrat të cilat varen nga INFRAKOS-i janë realizuar në kufijtë e paraparë me planin e biznesit.

**Ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor në mënyrë korrekte, transparente dhe jodiskriminuese** – INFRAKOS-i si Menaxher i rrjetit hekurudhor gjatë vitit 2023 përveç operatorit të transportit – TRAINKOS i ka qenë i gatshëm për të ofruar shërbime edhe operatorit tjetër privat RAILTRANS por që kompania private RAILTRANS nuk ka realizuar ndonjë transport. Ne me kënaqësinë më të madhe mund të konstatojmë se ofrimi i shërbimeve tona për këta operatorë ka qenë në nivelin më të lartë të mundshëm. Pra, ofrimi i të gjitha shërbimeve tona ndaj operatorëve të transportit ka qenë korrekt, me kohë dhe në nivelin më të lartë të mundshëm.

Ne përgjatë vitit 2023 e kemi bërë testin e kënaqshmërisë për ofrimin e shërbimeve tona dhe me kënaqësi mund të konstatojmë se operatorët e transportit nuk kanë pasur ndonjë vërejtje e cila vlen të përmendet. Sidoqoftë, ne edhe në vitin 2024 do të vazhdojmë të ofrojmë shërbime cilësore dhe gjithnjë duke i eliminuar mangësitë eventuale.

**Menaxhimi i mirëfilltë i patundshmërisë si resursi i dytë i krijimit te të hyrave dhe eliminimi i borxheve të këqija** – Një vëmendje e veçantë gjatë vitit 2023 i kemi kushtuar sektorit të patundshmërisë, sektor ky i cili tanimë për INFRAKOS-in krijon të ardhurat kryesore para qasjes në rrjetin hekurudhor. Me politika të mirëfillta, takime të rregullta me klientët tanë dhe një qasje shumë të favorshme ndaj tyre, ne kemi arritur që në vitin 2023 të kemi një realizim të tërësishëm të kësaj objektive.

**Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së parë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit)** – Ky është njëri ndër objektivat më të rëndësishëm të historisë së re të hekurudhave, sepse rehabilitimi dhe modernizimi i linjës së 10 hekurudhore është me rëndësi jetike për integrimin e sistemit hekurudhor të Kosovës në

rajon dhe BE. Gjatë vitit 2023 është punuar intensivisht në rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit), projekt ky i cili pritet të përfundon ne vitin 2024

**Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së dytë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë) –** Kanë vazhduar poashtu intensivisht punimet për rehabilitimin e këtij segmenti hekurudhor i cili pritet te përfundon ne vitin 2024.

**Fillimi i Projekt dizajnit detaj teknik për fazën e tretë (Mitrovicë – Leshak) –**
Projekti i Udhëhequr nga IPF 9 dhe Konzorciumi HILL International është bartur tek IPF 11 në Konzorcium me COËIn. Takimi i parë është mbajtur në muajin Tetor 2023 dhe kanë filluar punimet në dizajn. Projekti pra është ende në zhvillim dhe pritet të përfundon në fund të vitit 2024.

**Rihapja e pjesës veriore të Linjës së 10 hekurudhore nga Mitrovica në kufirin me Serbinë –** Është e ditur se që nga data 03 mars e vitit 2008 forcat e strukturave paralele Serbe në veri të Kosovës të ndihmuara nga Hekurudhat e Serbisë kanë okupuar pjesën veriore të Linjës së 10 Hekurudhore, duke ia pamundësuar kështu INFRAKOS-it qasjen në atë pjesë të hekurudhës. Ne kishim menduar se gjatë vitit 2023 do të ketë bisedime ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për këtë çështje, por për fat të keq kjo nuk ka ndodhë, gjë që si pasojë nuk është bërë realizimi i këtij objektivi.

**Ngritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë –** Edhe këtë vit, mund të konstatojmë me kënaqësi se INFRAKOS-i ka mbajtur dhe zhvilluar një aktivitet të shkëlqyer të bashkëpunimit me institucionet vendore, rajonale dhe ato të BE-së. këtu vlen të potencohet angazhimi i jonë maksimal në dhënien e informatave, hartimin e raporteve, plotësimin e pyetësorëve të ndryshëm dhe zhvillimin e komunikimit permanent me të gjitha institucionet tona shtetërore (në veçanti me Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, Ministrinë e Financave dhe Zyrën e Integrimeve Evropiane), me institucionet rajonale (në veçanti me hekurudhat Maqedonase, të Shqipërisë dhe ato të Malit të Zi), dhe së fundmi me institucionet e BE-së (në veçanti me BERZH-in, BEI-në, WBIF-in, CER-in), e kështu me radhë.

Këtu veçanërisht vlen të përmendet angazhimi i jonë në Komunitetin e Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor ku kemi pasur një bashkëpunim tepër të mirë me këtë institucion.

Ne gjithsesi që gjatë vitit 2023 do të zhvillojmë edhe më shumë komunikimin dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet e përmendura dhe palët e interesit, gjithnjë në drejtim të zhvillimit të sistemit hekurudhor të Kosovës.

## 6.3 Ndryshimet gjatë aktiviteteve

Si zakonisht edhe për vitin 2023 ne kemi hartuar planet e veprimit të bazuara në Planin e Biznesit të kompanisë. Këto plane kanë qenë mjaft të detajuara, mirëpo bazuar në rrjedhat ditore dhe kushtet ekzistuese, është dashur që të bëhen improvizime të caktuara duke bërë edhe ndryshimin e prioriteteve apo kohës së zbatimit të projekteve të caktuara. Duke dashur që ta ruajmë sigurinë financiare të kompanisë, ne kemi qenë shumë të kujdesshëm edhe në zbatimin e projekteve të planifikuara dhe kohës së zbatimit të tyre. Për shkak të situatës jo të mirë financiare ne kemi bërë edhe ndryshime të caktuara nga plani paraprak.

# 7 Shpenzimet kapitale dhe projektet

## 7.1 Shpenzimet kapitale dhe projektet

Sektori i prokurimit gjatë vitit 2023 ka qenë i angazhuar maksimalisht në realizimin e projekteve të parapara me planin e biznesit. Sektori i prokurimit ka vepruar në mënyrë aktive gjatë tërë vitit duke i proceduar me kohë të gjitha kërkesat e iniciuara nga departamentet dhe njësit kërkuese për projektet kapitale të INFRAKOS-it, si dhe duke i realizuar këto kërkesa sipas prioriteteve ekzistuese. Përkushtimi kryesor ka qenë që të gjitha procedurat për realizimin e këtyre projekteve të udhëhiqen në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në fuqi, si dhe këto projekte të realizohen me kohë. Gjatë vitit 2023 Infrakos ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka realizuar projekte kapitale të financuara nga:

- Projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës.
- Projektet e financuara nga Buxheti INFRAKOS-it.

### 7.1.1 Projektet kapitale nga Buxheti i Kosovës

Nga buxheti i Kosovës përmes Ministrisë së Ekonomisë për Infrakos Sh.A janë ndarë 500,000 € për financimin e projekteve kapitale, gjithashtu Ministria se Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka ndarë mjete për financimin e dy projekteve kapitale në vlerë prej 3,300,000 € për periudhe kohore tri vjeçare. Përkundër faktit që

marrëveshjet mes Ministrisë se Ekonomisë dhe Infrakos-it për financim projekteve kapitale, si dhe marrëveshjet mes Infrakos-it dhe Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për financimin e projekteve janë nënshkruar relativisht vonë, Infrakos me përpjekje maksimale dhe duke respektuar ligjin dhe rregullat e prokurimit publik ka arritur t'i realizoi shtatë projektet në vlerë prej 247,042.29 €.

### 7.1.2 Furnizimet dhe shërbimet nga buxheti i INFRAKOS-it

Gjatë vitit 2023 krahasuar me vitet paraprake janë realizuar një numër shumë i vogël i furnizimeve dhe shërbimeve tjera nga buxheti i INFRAKOS-it, duke u nisur nga marrja e shërbimeve të ndryshme, furnizimi me materialet shpenzuese e deri tek pjesët rezervë për mirëmbajtjen e stabilimenteve të ndryshme të infrastrukturës. Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i numrit të projekteve të realizuara në vitin 2023 dhe të financuara nga buxheti i kompanisë.

*Tabela 10. Numri i projekteve të realizuara*

| Furnizimet/Shërbimet e realizuara nga buxheti i INFRAKOS-it | Numri i projekteve | Vlera e planifikuar | Vlera e kontratave |
|---|---|---|---|
| | 41 | 35,255.00 | 31,799.38 |

INFRAKOS-i edhe në vitin 2023 ka qenë shumë aktiv në realizimin e suksesshëm dhe me kohë të projekteve të financuara nga buxheti i kompanisë. Prandaj ne besojmë që në vitet në vijim vlera e projekteve kapitale do të rritet dukshëm, por edhe mundësia financiare e INFRAKOS-it për zhvillimin e projekteve të nevojshme të kompanisë.

# 8 Perspektiva për vitin e ardhshëm

## 8.1 Perspektiva për vitin 2022

Viti 2023 ka qenë vit i zhvillimeve të rëndësishme, por edhe viti më sfidues për INFRAKOS-in. Kur themi se ka qenë vit i zhvillimeve të mëdha, këtë e bazojmë në një numër të madh dhe shumë të vlefshëm të projekteve të cilat janë kryer apo kanë filluar të zbatohen:

- Ka vazhduar rehabilitimi i fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit);

- Ka vazhduar rehabilitimi i fazës së dytë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë);

Pra, zhvillimet të cilat kanë ndodhur në vitin 2023 garantojnë një ecje të hovshme të INFRAKOS-it edhe në vitin 2024. Ne jemi të vetëdijshëm se çështja financiare e kompanisë tonë do të jetë e vështirë edhe në vitin 2024, sepse nuk pritet rritje e transportin nga operatorët hekurudhor mirëpo me nënshkrimin e kontratës financiare pesëvjeçare me qeverinë do ta kemi me të lehtë të vazhdojmë rrugëtimin e sukseseve.

Sidoqoftë, ne besojmë se perspektiva e INFRAKOS-it për vitin 2024 do të jetë dukshëm më e mirë, andaj edhe presim zhvillimet vijuese:

- Ka filluar hartimi i projekt dizajnit për fazën e tretë (Mitrovicë – Leshak – kufiri me Serbinë);

- Përfundimin e punëve në rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10 Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit);
- Përfundimin e punëve në rehabilitimin e fazës së dytë të Linjës së 10 Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë);
- Përfundimi i projekt dizajnit për fazën e tretë (Mitrovicë – Leshak – kufiri me Serbinë);
- Ofertimi dhe përzgjedhja e Kontraktorit për realizimin e punimeve në Fazën e parë dhe të dytë për sinjalizim dhe telekomunikacion;

Pra, nga prezantimi i projekteve të sipërpërmendura vërehet se viti 2024 do të jetë një vit tejet i ngarkuar me punë dhe projekte të cilat ne do të bëjmë çmos që t'i realizojmë me sukses. Realizimi i këtyre projekteve garanton një perspektivë shumë të mirë të INFRAKOS-it, me vazhdimin drejt zhvillimeve të reja dhe një suksesi të garantuar.

## 8.2 Objektivat kryesore sipas Planit të Biznesit për vitin 2024

Tanimë dihet se viti 2024 sikurse edhe viti paraprak do të jetë vit i zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore dhe projekteve tjera të rëndësishme. Në vijim janë paraqitur objektivat tona për këtë vit të cilat janë marrë nga Plani i Biznesit për vitin 2024. Prezantimi i këtyre objektivave nuk ka ndryshime qenësore nga ato të vitit paraprak, sepse ndërlidhja e tyre me sistemin hekurudhor është e shkëlqyer, ndërsa realizimi i tyre është çdoherë i mundur.

Pra, për vitin 2024 ne kemi përcaktuar objektiva të qarta të cilat do të mundësojnë zhvillimin më të hovshëm të kompanisë. Ndër objektivat e shumta do të përmendim këto:

- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin më të lartë të mundshëm konform rregullativave dhe legjislacionit në fuqi.
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit.
- Angazhimi maksimal në menaxhimin e mirë të resurseve ekzistuese për realizimin e të hyrave të parapara.
- Ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor në mënyrë korrekte, transparente dhe jo diskriminuese.
- Menaxhimi i mirëfilltë i patundshmërisë si resursi i dytë dhe tani i parë i krijimit të të hyrave dhe eliminimi i borxheve të këqija.
- Përfundimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së parë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit).
- Përfundimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së dytë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë).
- Fillimi i rehabilitimit të pajisjeve sinjalo siguruese dhe të energjetikës për fazën e parë dhe të dytë (Mitrovicë – Hani i Elezit).
- Përfundimi i Projekt dizajnit detaj teknik për fazën e tretë (Mitrovicë – Leshak).
- Rihapja e pjesës veriore të Linjës së 10 hekurudhore nga Mitrovica në kufirin me Serbinë.
- Ngritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë.

INFRAKOS-i do të ketë një angazhim maksimal gjatë tërë vitit 2024 ashtu që objektivat e sipërpërmendura dhe të përcaktuara me planin e biznesit të realizohen me sukses.

## 8.3 Ndryshimet nga plani i biznesit i vitit paraprak

Plani i biznesit për vitin 2024 u tha edhe më lartë se është shumë i ngjashëm me atë të vitit paraprak, ndërsa edhe objektivat e paraqitura në këtë plan nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të madh që vlen të potencohet.

Ngjashëm me vitin paraprak, objektivat në Planin e Biznesit të vitit 2024 janë shumë të qarta, duke filluar nga objektivat bazike të cilat përsëriten vazhdimisht e deri tek objektivat e reja të cilat janë futur në këtë plan të biznesit. Në këtë kontekst, mirëmbajtja e infrastrukturës, ngritja e sigurisë dhe kapacitetet njerëzore, ofrimi i shërbimeve të qasjes në rrjet dhe realizimi i të hyrave nga patundshmëria, mbesin akoma si objektivat kryesore të INFRAKOS-it edhe për vitin 2024.

# 9 Rreziqet e së ardhmes

## 9.1 Rreziqet për të ardhmen

Sfidat të cilat e kanë përcjellë INFRAKOS-in në vitet e kaluara, e sidomos të vazhduara edhe në vitin 2023 kanë qenë tepër të mëdha (kuptohet sa i përket gjendjes financiare), andaj falë parashikimeve tona paraprake dhe angazhimit maksimal, arritëm të mbijetojmë edhe vitin 2023. Mirëpo falë besueshmërisë dhe mirëbesimit është arritur marrëveshja financiare e cila është nënshkruar në fund të vitit 2023. Sipas analizave tona, rreziqet në vitet e ardhshme janë të ndikuara dhe varen nga shumë faktorë të ndryshëm në shumicën prej të cilëve ndikimi i INFRAKOS-it është shumë i vogël apo të themi zero.

Për këtë arsye, përveç angazhimeve maksimale të INFRAKOS-it në eliminimin e rreziqeve, do të duhet që urgjentisht të angazhohen edhe të gjitha institucionet tjera relevante (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe Ministria e Ekonomisë) ashtu që infrastruktura hekurudhore t'i eliminojë tërësisht apo t'i zvogëlojë maksimalisht këto rreziqe në mënyrë që rrjeti hekurudhor të jetë në nivelin e duhur dhe INFRAKOS-i të mund të ofrojë shërbime cilësore.

## 9.2 Rreziqet kryesore në dy vitet e ardhshme

INFRAKOS-i me planin e biznesit përmes SWOT analizës i ka përcaktuar qartë dhe në detaje rreziqet me të cilat mund dhe përballohet kompania e jonë. Në të njëjtën mënyrë është bërë edhe plani i veprimit përmes të cilit janë përcaktuar aktivitetet për eliminimin apo minimizimin e këtyre rreziqeve. Bazuar në përvojat e viteve paraprake ne i kemi përcaktuar qartë rreziqet kryesore të cilat do të mund ta cenojnë kompaninë në dy vitet e ardhshme.

Meqenëse rreziqet për dy vitet e ardhshme janë thuajse tërësisht të ngjashme me ato të trajtuara në raportin e vitit 2023, ne nuk kemi bërë ndryshime të përcaktimit të rreziqeve për vitin 2024, andaj përveç arritjes dhe nënshkrimit të marrëveshjes financiare 5 vjeçare mund të mbesin të njëjtat rreziqe:

- Mosfunksionimi i mirë i TRAINKOS-it;
- Mosfunksionimi i mirë i RAILTRANS-it;
- Humbja e klientëve të patundshmërisë;
- Financimi jo i mjaftueshëm i projekteve kapitale të infrastrukturës;

- Pamundësia e rihapjes së linjës veriore Mitrovicë – Leshak – Serbi;
- Kostoja e lartë e investimeve në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e linjave jashtë funksionit; dhe
- Dëmtimi dhe uzurpimi i infrastrukturës hekurudhore;

## 9.3 Komentimi i rreziqeve

Nga një numër i konsideruar i rreziqeve, ne kemi përzgjedhur rreziqet e mësipërme të cilat mund të ndikojnë negativisht në performancën e kompanisë. Këtu kemi parashtruar vetëm rreziqet të cilat konsiderohen si më të mëdha, dhe të cilat kanë ndikim kryesor në zhvillimin e INFRAKOS-it dhe performancën në tërësi. Secili nga rreziqet e përmendura mund ta rrezikon funksionimin normal të INFRAKOS-it, andaj edhe do të analizohen veç e veç.

**Mosfunksionimi i mirë i TRAINKOS-it dhe RAILTRANS-it –** Rënia e transportit të mallrave dhe ndërprerja e qarkullimit të disa nga trenat e udhëtarëve nga ana e TRAINKOS-it që në vitin 2020, nuk pritet të ndryshohet as gjatë vitit 2024. Startimi i dobët i operatorit privat të transportit RAILTRANS, paraqet të njëjtin rrezik të vazhdimit të gjendjes së njëjtë edhe gjatë vitit 2024. Meqenëse të hyrat kryesore të INFRAKOS-it varen nga këta dy operator të transportit, atëherë mosfunksionimi i mirë i tyre paraqet rrezik permanent për kompaninë tonë edhe gjatë vitit 2024. Prandaj, menaxhmenti i TRAINKOS-it, por edhe pronari i RAILTRANS-it do të duhej të angazhohen maksimalisht në gjetjen e mundësive për rritje të transportit të mallrave, sepse kjo do të ishte në dobi të kompanive të tyre por njëkohësisht edhe të INFRAKOS-it i cili do të kishte të hyra më të mëdha nga pagesat e qasjes në rrjet.

**Humbja e klientëve të patundshmërisë –** Pas të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet të cilat realizohen nga TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i, të hyrat tjera dytësore të INFRAKOS-it realizohen nga patundshmëria, respektivisht dhënia e patundshmërisë me qira për zhvillimin e bizneseve të ndryshme. Gjatë vitit 2023 të hyrat e realizuara nga patundshmëria kanë qenë më të mëdha se sa plani i paraparë. Mirëpo, duke marrë parasysh situatën e rëndë ekonomike në vend dhe rënien bizneseve private, një rrezik tjetër për kompaninë paraqet edhe mosrealizimi i të hyrave të planifikuara nga patundshmëria e cila mund të vjen si shkak i gjendjes së vështirë ekonomike dhe humbjes së klientëve ekzistues.

**Pamundësia e rihapjes së linjës veriore Mitrovicë / Leshak / Serbi –** Është e ditur se linja hekurudhore Mitrovicë - Leshak është e bllokuar nga serbët e veriut që nga viti 2008. Kjo ka pasur zhvillim negativ në të dyja vendet dhe për këtë kërkesat dhe nevojat e rihapjes së kësaj linje hekurudhore janë shumë të mëdha. Rihapja e kësaj linje hekurudhore do të mundësonte një zhvillim shumë më të madh të transportit hekurudhor dhe Kosovës e cila do t'i mundësohej edhe një qasje hekurudhore në shtetet e rajonit, në këtë rast në rrjetin e Serbisë. Rreziku i vazhdimit të situatës së njëjtë edhe në vitin 2024 është i madh, andaj pritet një angazhim më i madh i institucioneve tona përgjegjëse në zgjidhjen e këtij problemi.

**Kostoja e lartë e investimeve për rehabilitimin e linjave jashtë funksionit –** Një problem të veçantë për biznesin hekurudhor ka paraqitur pamundësia e futjes në funksion të tërë rrjetit hekurudhor. Interesimi i jonë gjatë vitit 2024 është që të gjejmë mundësinë e futjes në funksion të linjave të cilat që nga viti 1999 janë jashtë funksionit. Fjala këtu është për linjën Prishtinë – Podujevë dhe atë Klinë - Xërxe – Prizren të cilat për shkak të dëmtimeve tepër të mëdha janë jashtë funksionit. Kostoja e lartë e rehabilitimit të këtyre linjave është faktori kryesor i cili rrezikon mosfunksionimin e tyre, andaj mbetet që qeveria të gjejë mjetet e nevojshme për rehabilitimin e këtyre linjave.

**Dëmtimi dhe uzurpimi i infrastrukturës hekurudhore –** Dëmtimet e mëdha dhe uzurpimet nëpër vite të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës kanë qenë njëra ndër brengat dhe sfidat tona kryesore.

Përveç dëmtimeve, një çështje shumë brengosëse paraqesin edhe uzurpimet e ndryshme të cilat i bëhen infrastrukturës hekurudhore nga personat e pandërgjegjshëm fizik dhe juridik. Kjo është një dukuri e cila përcillet nëpër vite dhe për fat të keq infrastrukturës hekurudhore i ka shkaktuar dhe i shkakton dëme të pa kompensueshme.

## 9.4 Si të veprohet

Duke parë se rreziqet e mosfunksionimit të pritur të INFRAKOS-it janë të mëdha, ne me kohë kemi hartuar planet tona dhe në bazë të tyre planet e veprimit, ashtu që rreziqet e përmendura t'i zvogëlojmë në minimum apo t'i eliminojmë në tërësi. Zotimi i menaxhmentit të INFRAKOS-it është që të punojë pa ndalë për përmbushjen e Planit të Biznesit për vitin 2024 dhe objektivave që dalin nga ky plan. Ne jemi të vetëdijshëm për situatën ekzistuese ekonomike të vendit dhe problemet e mëdha të cilat i ndjekin të gjitha vendet e rajonit, por ne jemi të vetëdijshëm se pa sakrifica nuk ka as sukses. Andaj zotimi i jonë është se në vitin 2024 do të bëjmë sa vijon:

- Realizimin e plotë të planeve tona të veprimit të dala nga Plani i Biznesit;
- Bashkëpunimin e ngushtë me të gjitha palët e interesit;
- Përmirësimin e dukshëm të angazhimeve tona në arritjen e rezultateve më të mira, duke realizuar kështu synimet tona por me një kosto më të vogël;
- Hulumtimin e vazhdueshëm të mundësive të gjetjes së investimeve dhe mundësive të reja të përmirësimit të infrastrukturës;
- Mbrojtjen e aseteve dhe infrastrukturës hekurudhore;
- Zhvillimin e projekteve të ndryshme të patundshmërisë;
- Realizimin e menjëhershëm të detyrave tona rreth rehabilitimit gjeneral të linjës së 10 hekurudhore; dhe
- Ngritjen në maksimum të kujdesit ndaj sigurisë në komunikacionin hekurudhor.

INFRAKOS-i gjatë vitit 2024 do të ketë angazhime tejet të mëdha, qoftë në realizimin e detyrave ditore, qoftë në realizimin e projekteve zhvillimore, ndër të cilat do të veçojmë rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e Linjës së 10 Hekurudhore.

Si zakonisht dhe mbi të gjitha, si prioritet numër një do të jetë siguria e linjave tona hekurudhore, gjë që në këtë drejtim ne si gjithmonë do të jemi të pa kompromis dhe nuk do të lejojmë asnjëherë që linjat tona të mos kenë nivelin e duhur të sigurisë. Pra, puna e jonë dhe e tërë stafit të hekurudhës me angazhim maksimal do të vazhdojë edhe vitin 2024, por edhe në vitet tjera në vijim.

Për fund, ne garantojmë se do të vazhdojmë punën e pakursyer edhe në vitin 2024, ashtu që Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës të jetë pjesë e rrjetit të vendeve të rajonit dhe Rrjetit të Integruar të vendeve të BE-së.

*Fund*